

**RAPORT**

**I VLERËSIMIT TË JASHTËM**


**Për Programin e studimit BSc në “Administrim biznesi”**

**Universiteti i New York-ut në Tiranë**

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

**Prof. Dr. Klodjana Gorica**

**Prof. As.Dr. Arlinda Ymeraj**





(Nëntor/2018)

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit BSc në Administrim biznesi**

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti i NewYork në Tiranë
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASh Nr. 268, datë 28.06.2013
4	Urdhëri i akreditimit	*Akreditohet për herë të parë
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Administrim biznesi
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/ 6 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Aktivizimi i programit të studimit	2013-2014
17	Nr i studentëve	**11 studentë

*\*Programi i studimit vlerësohet për brezin e studentëve të rregjistruar në vitin akademik 2013-2014 dhe 2014-2015. Nuk ka qënë aktiv në vitet e tjera akademike pasi nuk ka patur studentë të rregjistruar*

*\*\*Në këtë program studimi janë regjistruar vetëm 2 breza studentësh në vite akademike 2013 – 2014 dhe 2014 - 2015.*

## HYRJE

### **Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Administrim biznesi**

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (më poshtë do të quhet Raporti) është hartuar në Vijim të detyrimeve për akreditimin e programit të Ciklit të Parë të studimeve Bachelor në "ADMINISTRIM BIZNESI" që zhvillohet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të New York-ut, Tiranë (UNYT).

UNYT u themelua në vitin 2002 mbështetur në ligjin Nr. 8461 datë 25.02.1999, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" (neni 1), i ndryshuar si edhe në zbatim të akteve të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 156, datë 22.03.2001, "Për Shkollën e Lartë Jo Publike në Republikën e Shqipërisë".

UNYT u liçensua nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Shqipërisë me Vendim Nr. 397 datë 15.08.2002, "Për dhënien e lejes për Hapjen e Shkollës së Lartë Universitare, Jo Publike "New York University-Tirana"". UNYT u riakreditua me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 102, datë 10.11.2017, në kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Garantimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë në Mbretërinë e Bashkuar (QAA).

Programet "Financë", "Administrim Biznesi" dhe "Sisteme të Informacionit" janë liçensuar me Urdhër të Ministrit Nr. 268, datë 28.06.2013, "Për hapjen e programeve të reja të ciklit të parë të studimeve Bachelor në "Financë", "Administrim Biznesi", "Sisteme të Informacionit", të Universitetit privat të New York-ut, Tiranë", mbështetur në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr 493, datë 03.06.2013

Programi Bachelor në Administrim Biznesi u krijua për herë të parë në vitin akademik 2013. Hapjes të programit i parapriu studimi i udhëhequr nga nevoja e njohjes dhe analizës së kërkesës së tregut. Ky program, përveç bazës legjislative të përshkruar më lart, sigurohet dhe funksionon mbështetur në rregulloren e posaçme të programit. Programi ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit dhe drejtohet nga Bordi i Programit (Aneks 23: Bordi Bsc në AB dhe kompetencat).

**Programi i studimit vlerësohet nga GVJ për brezin e studentëve të rregjistruar në vitin akademik 2013-2014 dhe 2014-2015. Programi nuk ka qënë aktiv në vitet e tjera akademike pasi nuk ka patur studentë të rregjistruar. Në këtë program studimi janë regjistruar vetëm 2 breza studentësh.**

### **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. Dr. Klodjana Gorica dhe Prof.Asoc.Dr.Arlinda Ymeraj si eksperte të jashtme vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.

Më datë 27.11.2018 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Në datë 03.12.2018 Institucioni ktheu përgjigje në formë zyrtare në lidhje me Draft – RVJ, në të cilën sprehet se **nuk ka komente** në lidhje me të.

Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.





# ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Mbështetur në dokumentacionin e sjellë në Dosjen e vetvlerësimit nga UNYT (DVV), Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se: Misioni i UNYT është përgatitja e udhëheqësve të ardhshëm nëpërmjet mësimdhënies, të të nxënit dhe hulumtimit duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit personal dhe influencës në komunitet, duke siguruar njohuritë, aftësitë, moralin dhe besimin e nevojshëm për të patur sukses në një mjedis heterogjen, ndërkombëtar.

Programi Bachelor në Administrim Biznesi ka për qëllim të ofrojë për studentët një kombinim të shkencave të menaxhimit dhe ekonomike të aplikuara në botën e biznesit, duke i ndihmuar ata t'u përshtaten tendencave të industrisë dhe të shërbimeve. Ky program është projektuar për të paisur studentët me njohuri, aftësi, mendim kritik dhe eksperiencë, që ju mundëson të diplomuarve të tij, të hyjnë me sukses në botën e profesioneve duke përdorur aftësitë e kultivuara. Ofrimi i programit mbështetet fuqishëm tek lidhjet industriale si edhe me institucionet financiare që UNYT ka krijuar e forcuar ndër vite në tregun shqiptar. Programi në dokumentacionin e tij specifikon qartë tre objektivat kryesore që vijnë:

- T'u mundësojë studentëve aplikimin e njohurive të fituara, në mënyrë kritike e analitike, në situata reale.
- Të aftësojë studentët në aplikimin e procesit të analizës të organizatave të biznesit dhe aktivitetit të tyre, duke identifikuar përparësitë, dobësitë me qëllim orientimin për përmirësime në të ardhmen.
- Të jenë të aftë të hartojnë dhe zhvillojnë një plan të thjeshtë biznesi.

Programi Administrim Biznesi është ideuar për të pajisur studentet me njohuri, aftësi, mendim kritik, dhe eksperiencë, që ju mundëson të diplomuarve të tij të hyjnë me sukses në botën e profesioneve duke përdorur aftësitë e kultivuara në këtë program, si p.sh. administrimi i biznesit dhe marketingu i produkteve dhe shërbimeve të tij, apo për të vazhduar studime të mëtejshme pasuniversitare.

Për të realizuar mësimdhënie cilësore, institucioni përpiqet të përmirësojë standardet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies, nëpërmjet përditësimit të tematikave në përputhje me zhvillimet më të fundit, në disiplinat përkatëse. Për këtë qëllim janë ndërtuar dhe/ose janë në proces ndërtimi disa dokumenta strategjikë, si Strategjia e Kërkimit 2014-2017 dhe Plani Strategjik 2018-2022.

GVJ, mbështetur në RVB, thekson se: UNYT investon në rritjen e kapaciteteve dhe intensitetit të kërkimit. UNYT mbështet kërkimin shkencor ndërdisiplinor ndërmjet të gjithë njësive bazë, departamenteve e qendrave kërkimore, si edhe në partneritet me institucione të tjera. Aktivitetet dhe produktet kërkimore synojnë jo vetëm të rrisin ndikimin në shkëmbimin e njohurive në komunitetin shkencor por edhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik social të vendit përmes trajtimit të problematikave me zgjidhje krijuese e rekomandime të qarta politike.

Në funksion të politikave të kërkimit shkencor në UNYT, ruajtja e integritetit, barazia dhe diversiteti mes stafit dhe studentëve të përfshirë në kërkim, janë thelbësore. UNYT ka organizuar tryeza diskutimi shkencor, seminare dhe konferenca ndërkombëtare, në të cilat çdo akademik e studjues mund të kontribuojë me punime të ndryshme shkencore, ku studentët janë të përfshirë. (Aneksi 21.5)

Metodologjia e përdorur në këtë vlerësim ndihmoi në konstatimin se UNYT është i angazhuar në zhvillimin intelektual, krijues dhe individual të studentëve të tij. Në kuadër të këtij angazhimi dhe në përputhje me misionin dhe objektivat e tij, Programi Bsc në Administrim Biznesi udhëhiqet nga strategjia afatgjatë e



ofrimit të njohurive të qëndrueshme, duke përshtatur objektivat akademike me kërkesat në ndryshim të tregut të punës si edhe me zhvillimet e politikave përkatëse në vend dhe në tregun ndërkombëtar.

Megjithatë, ndonëse institucioni udhëhiqet nga Strategjia Afatmesme 2018-2022, përgjatë vizitës në institucion dhe takimeve me drejtuesit e njësive bazë dhe grupet e fokusuara të punës, u evidentua mungesa e një studimi të mirfilltë të analizës së tregut dhe të tregut të punës, për mungesën e të cilave, edhe vetë institucioni ishte i ndërgjegjësuar.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi përmes dokumentacionit dhe nga takimet me drejtuesit e institucionit të UNYT se programi i studimit është ngritur mbi misionet dhe objektivat e përcaktuara në “Strategjinë e zhvillimit të programit”.</p> <p>Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe karakterizojnë profilin e programit. Të gjithë programet e studimit konceptohen dhe hartohen në bazë të misionit të UNYT.</p> <p>Tregu i punës dhe analiza koherente e tij, me prirjet dhe orientimet kryesore të zhvillimit, nuk janë të përditësuara, nuk kishte të dhëna por institucioni ofronte një strategji afatmesme që orientonte disa prej zhvillimeve strategjike të ardhshme.</p> <p>Nga takimet me drejtues të njësive bazë dhe fakultetit përkatës, argumentohet se vërtet mungesa e studimit të tregut përbën një dobësi. Universiteti do të ndërmarrë një strategji të re e cila do përfshijë jo vetëm një studim por edhe ndryshime jo vetëm në kurrikula, manaxhim financiar, organizim të brendshëm, burime njerezore.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Organizimi i programit të studimit është bazuar në dokumenta strategjike që orientojnë misionin, qëllimin, metodat, dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p> <p>Programet e studimeve të ofruara në UNYT janë në përputhje me planin strategjik për zhvillim të UNYT dhe synojnë pajisjen e studentëve me njohuritë bazë por edhe formimin e shprehive profesionale, si edhe me metodologjitë shkencore të përgjithshme.</p> <p>Dokumentacioni kryesor që mbështet përputhshmërinë e programeve me strategjitë për zhvillim të institucionit janë: Anekset përkatëse të Planit Strategjik UNYT 2012-2017 dhe Strategic Plan UNYT 2018-2022; Rregullorja e programeve Bachelor në gjuhën shqipe.</p> <p>Nga takimet në institucione me drejtuesit e njësive kryesore, strategjia e zhvillimit në të ardhmen, do të mbështesë politikat e orientimit të studentëve.</p>



**II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**  
**Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.**

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>b. kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Institucioni përpara hapjes së programeve në gjuhën shqipe ka ndërmarrë një studim tregu për të parë mundësinë e punësimit të studentëve, si dhe për të parashikuar numrin e pritshëm të studentëve që do të mund të regjistroheshin në këtë program. Kjo bazuar edhe në gjykimin mbi numrin e studentëve të regjistruar në programe të ngjashme në institucione simotra.</p> <p>Prurjet e ulëta dhe mos perceptimi i duhur nga tregu për këtë program kanë rezultuar edhe mbi një studim jo të plotë të tregut dhe gjithpërfshirës. Ky perceptim rezulton edhe nga vetë diskutimet me drejtues të strukturave të institucionit.</p> <p>Mungesa e një analize tregu, nevojash dhe prioritetesh koherente për vendin tonë dhe krahasimore me vendet e rajonit vështirëson ndërtimin e programeve në nivele vërtet aktuale, dhe që plotësojnë nevojat e tregut. Marrja përsipër e një studimi të tillë do të mbështesë, argumentojë dhe orientojë edhe ndryshime jo vetëm në kurrikula, manaxhim financiar, organizim të brendshëm, burime njerëzore.</p> <p>Përveç kësaj, është e nevojshme që përmes një analize të përgjithshme mbi prioritetet dhe degët kryesore të ekonomisë shqiptare:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përditësohet lista e bizneseve kombëtare</li> <li>• Të përfshihen më shumë biznese prodhuese dhe shërbimi/shoqëri të huaja prezente në vendin tonë/organizata të shoqërisë civile, dhe të zgjerohet rrjeti i bizneseve kombëtare dhe rajonale që përafrojnë me profilin e ofruar nga institucioni me qëllim rritjen e mundësive për praktika (internshipe) ashtu edhe mundësi punësimi.</li> </ul>
---	---

**Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare, dhe institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Siç edhe e kemi theksuar edhe më lart, Misioni i UNYT është përgatitja e udhëheqësve të ardhshëm nëpërmjet mësimdhënies, të nxëniet dhe hulumtimit duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit personal dhe influencës në komunitet, duke siguruar njohuritë, aftësitë, moralin dhe besimin e nevojshëm për të patur sukses në një mjedis heterogjen, ndërkombëtar, bazuar në rregulloren e programeve Bachelor në gjuhën shqipe, neni 7 mbi misionin dhe objektivat e programit dhe të UNYT dhe “Strategjinë e zhvillimit të programit”.</p>
--	--

**Konkluzionet e vlerësimit:**

GVJ gjykon se UNYT ka ndërtuar një praktikë pozitive dhe të qëndrueshme për funksionimin, realizimin dhe përputhshmërinë e qëllimeve dhe objektive të studimit me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, me strategjitë dhe ndjekjen e realizueshmërisë së tyre e të gjithë hallkave të procesit, duke bërë që realizimi apo problemet që mund të hasen në një hallkë të ndikojnë në etapat e tjera si dhe në të gjithë procesin. Objektivat janë përmbushur sipas përcaktimeve, por për të patur një vijueshmëri si dhe për t’u riaktivizuar



programi, edhe pse institucioni ka një strategji afatmesme 2018-2022, **rekomandohet që** institucioni të realizojë një studim tregu të orientuar sipas çështjeve që vijnë:

- Cilat janë nevojat e tregut shqiptar si dhe zhvillimet ndërkombëtare mbi aftësitë dhe njohuritë;
- Cilët janë sektorët prioritarë të ekonomisë shqiptare me ndikim të ndjeshëm në PBB dhe cilët do të jenë këta sektorë në të ardhmen e afërt, me qëllim që institucioni jo vetëm t'u paraprijë por të ofrojë programe të mirëkonceptuara që do t'i shërbejnë sigurimit të njohurive korente dhe të qëndrueshme në të ardhmen.

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

UNYT përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga 3 njësi kryesore, (Neni 9, Statuti i UNYT dhe Urdhëri MASR Nr.288, datë 22.05.2017), përkatësisht Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore dhe Fakulteti i Informatikës. Përgjegjës për programin Bsc Administrim Biznes është Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, njësia bazë e të cilit është Departamenti Administrim Biznesi si pjesë e organigramës së UNYT. Ky i fundit është strukturuar nga tre njësi bazë, përkatësisht dy departamente dhe nga një qendër kërkimore.

Në vitin akademik 2017-2018, Fakulteti kishte në përbërjen e tij 54 punonjës personel akademik efektiv dhe me kontratë si edhe personel administrativ, nga të cilët Personelit Akademik Efektiv (PAE) me kohë të plotë përbëhet nga 21 punonjës, ku secila njësi bazë ka në përbërjen e saj 7 punonjës. Të paktën tre punonjës mbajnë gradën "Doktor".

Numri i Personelit Akademik me Kontratë (PAK) me kohë të pjesshme është 12. Të tre njësitë e fakultetit koordinojnë aktivitetin mësimor dhe shkencor për programin e studimit Bsc në Administrim Biznesi. Mësimdhënia dhe veprimtaria shkencore e fakultetit mbështetet nga stafi administrativ.

GVJ ju komunikua gjatë vizitës në Institucion se: Struktura administrative pranë UNYT ndahen në njësi administrative me rëndësi parësore, për funksionimin e çështjeve akademiko administrative të Universitetit si edhe në njësi ndihmës akademike, që ofrojnë shërbime të ndryshme.


Njësitë Administrative akademike janë: Zyra e Financës, Zyra e Sekretarisë Mësimore, zyra e Pranimit të Studentëve, Zyra e Marketingut dhe e Marëdhënieve me Publikun, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Menaxhimit të Shërbimeve, Zyra e Menaxhimit të projekteve, Zyra e Koordinimit të SUNY/ESC, Zyra e Mbështetjes me Teknologji Informacioni, Biblioteka, Zyra e Karrierës dhe Çështjeve Studentore Dekani i Studentëve, Zyra e Marëdhënieve me Jashtë.

Njësi Ndihmës Akademike janë:

- Qendra e Matematikës,
- Qendra e Shkrimit Akademik,
- Qendra e Këshillimit dhe Mbështetjes Akademike.



## Organigrama



UNYT i mbulon nevojat e tij akademike kryesisht me staf vendas ose të huaj që gjendet në vend, si edhe angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e objektivave të programeve të ciklit të parë.

Nevojat për personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ, si edhe të dhënat mbi shpërndarjen e ngarkesës për personeli akademik dhe marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit paraqiten në tabelat 4,5,6.1 dhe 6.2, si edhe tabela 13 në Aneks.

UNYT zbaton procedurat ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit akademik. Kriteret dhe procedurat e përgjithshme dhe transparente për seleksionimin dhe rekrutimin e stafit paraqiten në Aneksin 7.1. "Kriteret dhe procedurat e rekrutimit". Jetëshkrimet e stafit të angazhuar në program paraqiten në Aneksin 2.2. "CVs". Procedura e përzgjedhjes në UNYT I kushton vëmendje të veçantë ekspertizës akademike, pedagogjike e kërkimore që kandidatët demonstronjë.

Baza e të dhënave e njësisë është e plotë dhe rifreskohet në përputhje me ndryshimet e kryera. Dosjet e punonjësve përmbajnë të dhënat e tyre personale, profesionale, listën e arritjeve akademike si edhe referencat e punëdhënësve të mëparshëm. UNYT i kushton vëmendje politikës të trajtimit të burimeve njerëzore.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

GVJ, në përputhje me misionin e tij si edhe mbështetur në dokumentacionin përkatës dhe në vizitën e kryer në institucion, konstatoi se Struktura akademike e Fakultetit përputhet me përshkrimin e dhënë nga RVB.

Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit në të cilin bënë pjesë programi i studimit Bachelor në Administrim Biznesi është i përbërë nga:

- Departamenti i Administrim Biznesit
- Departamenti i Ekonomisë dhe Financës



- Qendra Kërkimore për Ekonominë dhe Biznesin

GVJ, pasi analizoi të dhënat e tabelave nga 1 deri 6 (6/1 dhe 6/2) si edhe pasi I ballafaqoi ato me dokumenta të tjerë dhe diskutime në institucion gjatë vizitës, konstatoi se struktura akademike është ndërtuar në funksion të plotë të misionit të njësisë bazë, të kërkesave të programit si edhe të kërkesave të universiteteve partnerë në ShBA. Ndonëse gjatë diskutimit në institucion, u paraqitën argumenta dhe kundër/argumenta rreth strukturës, ekipi drejtues i UNYT është i bindur se struktura e zgjedhur është efektive dhe mbështet plotësisht institucionin në arritjen e misionit dhe objektivave të tij.

Institucioni ofron edhe programe në gjuhën shqipe, programe të cilat nga studentët aplikantë janë mirëpritur për shkak të lehtësive që iu siguron. Megjithatë perceptimi i tregut nuk përputhet me pritshmëritë e institucionit, sepse numri i aplikantëve në këtë program ka qenë i ulët. **Ashtu sikurse GVJ është shprehur edhe më lart, ky program studimi ka patur vetëm dy breza studentësh të rregjistruar të cilët janë objekt i këtij vlerësimi.**

Çështje e rëndësishme së veçantë, e diskutuar e gjerësisht edhe gjatë vizitës së GVJ në Institucion, është çështja e zhvillimit të institucionit në të ardhmen, si rezultat i ndryshimit të raporteve në këshillin e aksionerëve për shkak të shitjes së aktivitetit. Ndonëse Departamenti i Administrim Biznesit, me përfshirjen e plotë të studentëve dhe nën drejtimin e pedagogëve, ka përgatitur një plan strategjik afatmesëm, ky plan ende nuk është zbatuar. Plani do të paraqitet më parë tek Këshilli i ri i Aksionerëve, pas ndryshimit të pronësisë mbi UNYT. Gjithsesi, në kushtet e mungesës së një studimit të plotë mbi Nevojën e Tregut si edhe të ndryshimit institucional të përshkruar më lart, zhvillimet e tregut dhe konkurrenca mund të përbëjnë rreziqe të shtuara për aktivitetin e institucionit.

Ekipi i UNYT konsideron përparësi lidhjen e fuqishme me programet simotra në ShBA, përparësi të cilën deri tani, tregu shqiptar i biznesit e ka konsideruar si përparësi të këtij programi studimesh. Për rrjedhojë, GVJ gjykon se UNYT duhet të mbështetet tek “marka e studimeve e krijuar“, tek vlerat e saj.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Stafi akademik i UNYT paraqitet i motivuar, motivim i cili është rrjedhojë kryesisht e lirisë akademike, e mundësisë së pjesëmarrjes në kërkime shkencore, e vlerësimit institucional, fleksibiliteti dhe liria në zgjedhje. UNYT ndjek politikë të veçantë për motivimin e stafit, e cila konsiston në evidentimin e praktikave të mira akademike dhe në promovimin e tyre. Politika e Promovimit të Stafit është diskutuar gjerësisht ndërmjet anëtarëve të stafit, më pas u diskutua në Senat dhe u miratua.

Departamenti i Administrim Biznesit përgjatë viteve përbëhet si më poshtë:

- Viti akademik **2017-2018** - nga 12 punonjës, personel akademik, përkatësisht **7 PAE** dhe **5 PAK**. Personeli akademik efektiv (PAE) përbëhet nga 3 PhD/Dr, 2 PhD Kand/Dr në proces dhe 2 MSc. Personeli Akademik me Kontratë përbëhet nga 1 Prof.Asoc, 3 PhD/DR dhe 1 PhD Kand.
- Viti akademik **2016-2017** - **7 PAE**, nga të cilët 1 prof; 3 Phd/Dr; 2 Phd/Dr në proces dhe 1 MA; si dhe nga **5 PAK** nga të cilët 1 Prof. As; 3 Phd/Dr; 1 Phd/Dr në proces;
- Viti akademik **2015-2016** – **7 PAE** nga të cilët 4 Phd/Dr; 2 Phd/Dr në proces; 1 Ma; dhe nga **3 PAK** nga të cilët 2 Phd/Dr në proces dhe 1 MBA
- Viti akademik **2014-2015** – **8 PAE**, nga të cilët 6 Phd/Dr; 1 Dr në proces; 1 MA si dhe **6 PAK** nga të cilët 2 Dr/Phd; 3 Phd/Dr në proces; 1 Ma
- Viti akademik **2013-2014** – **7 PAE** nga të cilët 2 Phd/Dr; 1 Phd/Dr në proces; 4 MA si dhe nga **12 PAK** nga të cilët 2 Prof Dr; 2 Phd/Dr; 4 Phd/Dr në proces dhe 4 MA

*Të dhëna më të detajuara gjenden në Aneksë, tabela 1-3*



GVJ konstatoi se stafi i UNYT, si stafi akademik dhe ndihmës mësimor-shkencor është i kualifikuar, në përputhje me kërkesat dhe misionin e njësisë. UNYT gëzon reputacion, rrjedhë kryesisht e cilësisë profesionale dhe nivelit akademik të UNYT.

Stafi i UNYT është gjithashtu i motivuar dhe përballet me përgjegjësi me vështirësitë e mësimdhënies, sidomos në kushtet e një stafi relativisht të vogël në numër në raport me numrin e madh të lëndëve që duhet të përballojë mesatarisht një pedagog.

Për të arritur qëllimet e tij, GVJ ju komunikua nga drejtuesit e Institucionit, se për një proces mësimor të individualizuar, të gjitha klasat në UNYT përbëhen nga mesatarisht 15 deri 25 studentë. Në programin Bsc në Administrim Biznesi, ky numër ka qenë edhe më i kufizuar për shkak të numrit të ulët të regjistrimeve në këtë program. GVJ konfirmon se studentët konsiderojnë përparësi mundësi e zhvillimit të mësimin në klasa të përmasave të tilla, sepse kjo lehtëson procesin e mësimdhënies si edhe rrit efektivitetin e tij.

Dokumentacioni mbështetës për këtë rubrikë

Aneksi 9: Struktura organizative e IAL dhe e programeve

Aneksi 23: Bordi Bsc në AB dhe kompetencat

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit përbëhet nga 54 punonjës, nga të cilët 33 janë punonjës akademikë, përkatësisht PAE (21) dhe PAK(12), ndërsa 21 janë PA. Fakulteti përbëhet nga 3 njësi, përkatësisht Departamenti i Administrim Biznesit, Departamenti i Ekonomisë dhe Financës dhe Qendra Kërkimore për Ekonominë dhe Biznesin.

Siç edhe e kemi paraqitur në Rubrikën 2, Departamenti i Administrim Biznesit përbëhet nga 12 punonjës, personel akademik, përkatësisht 7 PAE dhe 5 PAK, të gjithë me arsim të lartë. Personeli akademik efektiv (PAE)përbëhet nga 3 PhD, 2 PhD Kand dhe 2 MSc. Personeli Akademik me Kontratë përbëhet nga 1 Prof.Asoc., 3 PhD dhe 1 PhD Kand.

Qendra Kërkimore për Ekonominë dhe Biznesin e cila mbështet aktivitetin e të dy departamenteve përbëhet nga 7 PAE, përkatësisht 1 Prof.Asoc, 2 PhD, 1 PhD Kand. dhe 3 MSc.

Numri i përgjithshëm i personelit Administrativ është 21, të gjithë me arsim të lartë, përkatësisht 1 PhD Kand, 11 MSc, 2 MBA dhe 2 MP. Vetëm 5 punonjës kanë përfunduar studimet në Bachelor.

Stafi akademik në funksion të programit të studimit paraqitet si më poshtë ndër vite:

- Viti akademik **2017-2018** – **Nuk ka të dhëna pasi programi nuk ka qenë aktiv**
- Viti akademik **2016-2017** – **5 PAE**, nga të cilët 3 Phd dhe 2 Phd në proces; dhe **0 PAK**
- Viti akademik **2015-2016** – **8 PAE**, nga të cilët 1 Prof As; 5 Phd; 2 Phd në proces; 1 MA, dhe **1 PAK (1 Prof As)**
- Viti akademik **2014-2015** – **11 PAE**, nga të cilët 5 Phd/Dr; 3 Phd/Dr në proces; 3 MA, dhe **1 PAK (Prof As)**
- Viti akademik **2013-2014** – **7 PAE**, nga të cilët 1 prof. Dr; 4 Phd/Dr; 2 MA dhe **3 PAK** nga të cilët 1 Phd në proces dhe 2 MA



Nga të dhënat e marra në Institucion, rezulton se mosha e personelit akademik të brendshëm (PAE) dhe personelit administrativ (PA) në vite ka qënë si më poshtë

- Viti akademik 2015-2016, mosha ka qënë nga 25 vjeç (9 pedagogë) dhe deri në 65 vjeç (2 pedagogë)
- Viti akademik 2016-2017, mosha ka qënë nga 25 vjeç (7 pedagogë) dhe deri në 65 vjeç (1 pedagog)

Përsa i përket personelit me kohë të pjesshme (PAK), rezulton se nuk ka pasur të tillë në vitin akademik 2016-2017, ndërsa në vitin akademik 2015-2016, ka qënë vetëm një pedagog i grupmoshës 36-45 vjeç.

UNYT ka vënë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikqyrjen e studentëve të programit në projektin final. Pjesa e parë, propozim dhe kërkim e projektit final është organizuar me 20 orë në auditor dhe me 160 orë jashtë auditorit. Ndërsa pjesa e dytë, tema e projektit final është organizuar me 10 orë në auditor dhe 170 orë jashtë auditorit (Aneksi 23: Lista e lëndëve të programit dhe lista e pedagogëve). Secili student propozon temën që dëshiron të zhvillojë, e cila miratohet nga bordi i programit, së bashku me instruktorin udhëheqës, sipas fushës të interesit të studentit. Mesatarisht një instruktor udhëzon 6 deri 7 studentë (Aneks 23 "Bordi Bsc në AB dhe kompetencat").

GVJ konstaton se: UNYT ndjek procedurat ligjore dhe institucionale në rekrutimin e personelit akademik. Drejtoria e Burimeve Njerëzore kujdeset për zbatimin e hapave të procesit. Pasi identifikohet vendi vakant dhe miratohet nga autoritetet akademike, UNYT publikon njoftimin mbi "vendin/vendet vakant", së bashku me përshkrimin e cilësive të vendit të punës. Njoftimi publikohet në median e shkruar dhe elektronike, kombëtare dhe ndërkombëtare. Komiteti i Kërkimit shqyrton aplikimet, vlerëson dëshmitë e dokumentuara dhe përgatit listën e shkurtër të kandidatëve më të mirë, të cilët ftohen në intervistë.

Në procesin e përzgjedhjes mbahen në konsideratë kriteret që vijojnë:

- Cilësia e arsimimit dhe institucioni nga i cili është fituar tituli "Doktor",
- Titujt akademikë,
- Të dhënat kërkimore (Veprimtaritë kërkimore dhe rezultatet),
- Filozofia e mësimdhënies dhe eksperiencia,
- Referencat/letrat e rekomandimeve.

Pas përfundimit të afatit të aplikimeve, ndiqen hapat proceduriale të të përcaktuar në rregullore, përkatësisht: mbledhja e dokumentave, shqyrtimi i tyre dhe përgatitja e listës së shkurtër, intervistimi dhe përzgjedhja e kandidatëve finale.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat,

Stafi akademik në funksion të programit të studimit paraqitet si më poshtë:

- Viti akademik **2017-2018** – **Nuk ka të dhëna pasi programi nuk ka qënë aktiv**
- Viti akademik **2016-2017** – **5 PAE**, nga të cilët 3 Phd dhe 2 Phd në proces; dhe **0 PAK**
- Viti akademik **2015-2016** – **8 PAE**, nga të cilët 1 Prof As; 5 Phd; 2 Phd në proces; 1 MA, dhe **1 PAK (1 Prof As)**

*Të dhëna më të detajuara gjenden në Anekse, Tabela 3-6*

Megjithatë GVJ konstatoi se ngarkesa mësimore është tepër e lartë, e shprehur si në numrin mesatar të orëve në auditor (296 orë efektive), ashtu edhe në numrin e lëndëve, të zhvilluara nën përgjegjësinë e një lektori (6 deri 7). Ndonëse evidencat mbi ndikimin e ngarkesës në cilësinë e mësimdhënies mungojnë, besohet se një ngarkesë e përmasave të tilla, përballohet nga stafi akademik, me vështirësi.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre



Në këtë departament, 50% e personelit mban gradën shkencore PhD (3 PAE dhe 3 PAK), 25 % është PhD Kand (2 PAE dhe 1 PAK), ndërsa 25 % e personeli akademik përfaqësohet nga 1 PhD (PAK) dhe 2 MSc (PAE)

Stafi akademik i UNYT është i kualifikuar. Ndonëse në vitin e fundit, 2017 - 2018, në stafin akademik Efektiv (PAE) të Departamentit të Administrim Biznesit, numri i akademistëve me gradë “Profesor” është zvogëluar, në krahasim me një vit më parë, në përgjithësi dominojnë akademistët me gradë “Phd”, kryesisht të fituar në universitete të huaja. Sa i përket stafit akademik me kontratë, niveli i lartë akademik i tij, konfirmohet nga niveli i “Gradave Shkencore” si edhe nga eksperiencia e larmishme e punës. Megjithatë, GVJ konkludoi se një mekanizëm i strukturuar i vlerësimit të ecurisë të stafit, i mbështetur dhe i argumentuar nga tregues të matshëm, mungon.

Të dhënat sipas seksit, Të dhëna sipas moshës së personelit

Departamenti Administrim Biznesi, siç konstatohet nga të dhënat e disponuara e konsideron barazinë gjinore. Personeli akademik i gjinisë femërore dominon, si ndërmjet PAE (4:3), ashtu edhe ndërmjet PAK (3:2). Në nivel departamenti dominon grup moshë e re, deri 45 vjeç.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Stafi i UNYT njihet me kontratën e punës, të cilat janë të formalizuara dhe të ndërtuara në përputhje me legjislacionin mbi “Kodin e Punës në Shqipëri”. Megjithatë, diskutimet me stafin evidentuan mungesën e përshkrimeve të qarta, specifike e të sakta të posteve të punës.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi ndihmës si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor, është plotësisht i aftë të mbështesë proceset akademike dhe ato operacionale të UNYT. Stafi mbështetës është i barabartë me stafin efektiv në numër, ndërsa në aspektin cilësor, gjykohet që shkalla e përgatitjes dhe e eksperiencës është plotësisht e përshtatshme në raport me aktivitetin e institucionit.

Dokumentacioni mbështetës në këtë rubrikë

Aneks 7.2 Kopje e kontratës së punës

Aneksi 9: Struktura organizative e IAL dhe e programeve

Ngarkesa e stafit akademik

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	GVJ mbështetur në RVB si edhe në dokumentat e shqyrtuara, përpara e gjatë vizitës në institucion, konfirmon se procedurat ligjore të ndjekura për rekrutimin e personelit janë transparente dhe në përputhje me statutin dhe rregulloren. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs.
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;	Ngarkesa e Personelit akademik i cili ka mbuluar këtë program ndër vite paraqitet si vijon: Viti akademik 2013-2014 është mbuluar 70% nga PAE dhe 30% nga PAK Viti akademik 2014-2015 është mbuluar 92% nga PAE dhe
<b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	



<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>8% nga PAK  Viti akademik 2015-2016 është mbuluar 91% nga PAE dhe 9% nga PAK  Viti akademik 2016-2017 është mbuluar 100% nga personeli akademik i angazhuar me kohë të plotë.  <b>Nuk ka personel akademik për vitin 2017-2018, pasi programi nuk ka qënë aktiv.</b>  GVJ është i mendimit se numri i pedagogëve është shumë i vogël në krahasim me lëndët që mbulon programi, gjë e cila reflektohet edhe në ngarkesën mësimore e cila është tepër e lartë, e shprehur si në numrin mesatar të orëve në auditor (296 orë efektive), ashtu edhe në numrin e lëndëve, të zhvilluara nën përgjegjësinë e një lektori (6 deri 7).  Ndonëse evidencat mbi ndikimin e ngarkesës në cilësinë e mësimdhënies mungojnë, besohet se një ngarkesë e përmasave të tilla, përballohet nga stafi akademik, me vështirësi (një program me mesatarisht 22 provime duhet të mbulkohet nga 5 pedagogë).  Institucioni i kushton vëmendje të veçantë procedurës së vlerësimit të pedagogut, si përpara kontraktimit ashtu edhe përgjatë aktivitetit të tij akademik në institucion.  Ndërsa vlerësimi përpara kontraktimit bëhet me mënyrat standarte të vlerësimit (institucioni i aplikon të gjitha mënyrat, me qëllim që të garantojë kontraktimin e kandidatit më të mirë), vlerësimi përgjatë aktivitetit akademik në institucion realizohet me disa menyra si :  <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimit nga kolegët (peer review);</li> <li>• Vlerësimit nga studentët;</li> <li>• Vlerësimit nga drejtuesit e NYUT në fund të vitit akademik (procesi follow-up)</li> </ul> Zyra e burimeve njerezore mban dhe ruan një bazë të plotë dhe të qartë të raporteve të rekrutimit, që nga marrja e vendimit për shpalljen e njoftimit deri tek kontraktimi.  Manuali për Sigurimin e Cilësisë udhëheq veprimtarinë e institucionit në procesin e mbikqyrjes të standarteve të cilësisë si edhe të garantimit të tyre.</p>
<p><b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;  <b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;  <b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;  <b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor., ose titullin akademik “Docent,,</p>	<p>GVJ pasi analizoi përshkrimet e RVB si edhe dokumentacionin e UNYT në lidhje me këtë rubrikë, konstaton se institucioni disponon bazën e plotë të të dhënave për personelin akademik të përfshirë në realizimin e programit të studimit “Administrim Biznesi“.  Institucioni disponon listën e plotë të stafit akademik për secilin semestër, të pedagogëve ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ. Kjo listë gjendet në Zyrën e Burimeve Njerezore dhe pranë departamenteve.  Institucioni në faqen e tij zyrtare në web publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Këto kritere janë të ruajtuara dhe në raportet përkatëse të rekrutimit. Pedagogët e angazhuar në programin e studimit si titullarë lëndësh mbajnë së paku gradën shkencore PhD, të fituar kryesisht jashtë vendit.</p>
<p><b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për</p>	<p>Kriteri 1 nuk aplikohet.</p>



<p>realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>GVJ, i ë vijim të përfundimeve të RVB si edhe duke u mbështetur në diskutimet me drejtuesit dhe personelin akademik të UNYT, gjykon që burimet njerëzore përdoren në mënyrë efektive për përmbushjen e objektivave të programit të studimit.</p> <p>Për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale si edhe mbikëqyrjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin akademik e në veçanti në fazën e përgatitjes së temës përfundimtare, në UNYT funksionon Zyra e Karrierës, e cila ka lidhur memorandum bashkëpunimi me shumë institucione dhe kompani private, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar akomodimin e studentëve në këto institucione. Krahas rolit të kësaj zyre, studentëve u caktohet një pedagog mbikëqyrës, i cili ndjek zhvillimin korrekt të praktikës mësimore në institucionin pritis dhe jep vlerësimin e tij në përfundim të kryerjes së praktikës nga ana e studentit. Standarti i ngarkesës, 1 instruktor për 12 studentë, jo vetëm respektohet plotësisht, por tejkalohet sepse në UNYT norma e ngarkesës është 1 pedagog udhëheq e mbikëqyr 6 deri 7 studentë.</p>
<p><b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtëjshëm të personelit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtëjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ndjek me vëmendje kualifikimin profesional të pedagogut dhe për këtë organizon edhe veprimtari mbështetëse didaktike. UNYT është i angazhuar maksimalisht për të nxitur kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtëjshëm të personelit të tij. Ai mbështet zhvillimin e konferencave shkencore nga njësitë bazë, si edhe të aktiviteteve të tjera.</p> <p>Zbatimi i programit dhe vazhdueshmëria e tij kanë krijuar mundësinë e krijimit të një bazë të dhënash shpjeguese për arritjet dhe problemet. Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>GVJ, në përputhje dhe në zbatim të metodologjisë së përzgjedhur, gjykon se UNYT trajton me prioritet të veçantë çështjen e burimeve njerëzore, gjë e cila shfaqet, jo vetëm në zbatimin e procedurave ligjore të rekrutimit, por edhe në drejtim të zhvillimit dhe rritjes profesionale me qëllim përmbushjen e objektivave të programit. Në veçanti, institucioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zbaton kriteret institucionale dhe praktiket e mira në raport me menaxhimin e Burimeve Njerëzore, të personelit akademik dhe të atij mbështetës, përmbushen.</li> <li>2. Mbikëqyr me rigorozitet zbatimin e Manualit për Sigurimin e Cilësisë.</li> <li>3. Ndjek me vëmendje dhe mbështet kualifikimin profesional të personelit akademik.</li> </ol> <p>GVJ vlerëson se standardet e menaxhimit të burimeve njerëzore, të personelit akademik dhe atij mbështetës plotësohen. <b>Sidoqoftë ka vend për të tërhequr vëmëndjen</b> në lidhje me ngarkesën e lartë në auditor si edhe përsa i përket numrit të lëndëve për të cilat një lektor është përgjegjës.</p>	



#### **4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

UNYT I kushton vëmendje infrastrukturës dhe rolit të saj në rritjen e cilësisë të programeve mësimore. GVJ konsideron vendim të logjikshëm zhvendosjen e institucionit dhe kryerjen e veprimtarisë akademike tek “Kodra e Diellit”, një godinë 7 katëshe, me një pamje tejet piktoreske.

Infrastruktura e institucionit dëshmon jo vetëm seriozitetin dhe përgjegjshmërinë e stafit, por edhe funksionalitetin e saj në shërbim të cilësisë së programeve. UNYT paraqitet I kompletuar me salla leksioni, seminare, konferenca, laboratore si edhe me të gjitha paisjet e nevojshme teknike dhe didaktike, me një mobilim tejet të këndshëm dhe të përshtatshëm.

Edhe infrastruktura ndihmëse (furnizimi me energji elektrike, uji, ngrohja) janë siguruar në shërbim të cilësisë së programeve të studimit dhe të komoditetit të personelit akademik dhe studentëve.

Siç paraqitet në tabelën 7, Aneks, UNYT iu përmbahet normave të hapësirës së përdorshme, me një raport prej 2.5 deri në 5 m<sup>2</sup> për student.

Biblioteka e UNYT siguron një ambient pozitiv, të përshtatshëm dhe të rehatshëm për lexuesin, infrastrukturë teknike për zhvillimin dhe përdorimin e burimeve online për kërkim shkencor, burime informacioni për studentët dhe stafin akademik.

Studentët mund të shfrytëzojnë për qëllimet kërkimore edhe baza të të dhënave dhe burime nga universitetet partnere të UNYT. Gjithashtu UNYT ju ofron studentëve qasje të specializuara, soft ware (TURNITIN) për qëllime të identifikimit të plagjiaturës si edhe të marrjes së komenteve e opinioneve menjëherë.

Siç edhe u shpjegua më lart, UNYT përbëhet përveç dy departamenteve edhe nga një qendër kërkimore, e cila është në funksion dhe në mbështetje të drejtpërdrejtë të veprimtarive mësimore e kërkimore shkencore të programit.

##### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

GVJ konstaton se situata e infrastrukturës e paraqitur dhe e përshkruar në RVB përputhet me situatën reale, të konstatuar gjatë vizitës në institucion.

GVJ gjykon që Infrastruktura në përgjithësi, është një nga përparësitë e UNYT. Jo vetëm infrastruktura akademike, por edhe ambientet kulturore, sportive, argëtuese e zhvilluese janë të përshtatshme për të mbështetur cilësinë e punës kërkimore dhe garantuar mirëqenien dhe shëndetin e studentëve dhe stafit akademik. Institucioni e ka trajtuar me shumë vëmendje çështjen e infrastrukturës. Në të gjitha diskutimet, studentët kanë qenë pjesë e vendimmarrjes dhe mendimi i tyre është konsideruar. Jo vetëm zbatimi i normave, siç edhe ilustron nga tabela 7, por edhe opinionet e të intervistuarve, forcojnë bindjen e GVJ se UNYT ka investuar me seriozitet, në funksion të ndërtimit të një infrastrukture që ti shërbejë mësimdhënies cilësore.

Në Takimet me përfaqësuesit e studentëve GVJ evidentoi problemin e vështirësive për arritjen e mësimi në kohë, për shkak të distancës dhe transportit, ndonëse institucioni është përpjekur që të ofrojë zgjidhje. Gjithsesi, kjo çështje duhet të rishikohet dhe diskutohet me studentët, si grupi kryesor i interesit.



## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b> <b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>GVJ mbështetur tek të dhënat e siguruar nga RVB si edhe nga vizita në institucion konstaton se institucioni, në përpjekje për të realizuar një proces mësimor sa më cilësor, ju siguron studentëve akses tek literature e zgjedhur, bashkëkohore dhe në sasi të mjaftueshme. Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme nëpërmjet bibliotekës, e cila disponon literature cilësore dhe të pasur, kryesisht në gjuhë të huaj, në fushën e shkencave ekonomike, tekste mësimore dhe literature ndihmëse.</p> <p>Biblioteka e UNYT është e pasur dhe disponon literaturën e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Biblioteka ka mjaftueshëm vende leximi dhe paisje teknologjike, për të garantuar punën akademike dhe kërkimin shkencor të studentëve.</p> <p>Biblioteka e UNYT furnizohet vazhdimisht me botime periodike. Institucioni mbështet gjetjen e burimeve on-line të kërkuar nga pedagogët dhe studentët. Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare më prestigjioze (McGraw-Hill) (marëveshje 2017)</p> <p>Orari i shërbimit është i njohur për studentët dhe i përshtatshëm sepse biblioteka është e hapur gjatë të gjithë ditës.</p>
<b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programstimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion vërejtë se: UNYT ka krijuar një strukturë logjistike të vlerësueshme për punën e pedagogëve dhe të studentëve në ambientet e tij. UNYT ka aktualisht në përdorim 4 laboratorë mësimorë si edhe salla mësimore, (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit.</p> <p>Pajisjet e mjediseve mësimore në UNYT janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor, këtu përfshihen PC-te Projektorët dhe Sistemi i fonisë. Pajisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit.</p> <p>UNYT ka krijuar mundësinë e pajisjes së sallave mësimore me mjete moderne për t'u përdorur nga pedagogët dhe për të perfeksionuar procesin mësimor me mjetet teknologjike audiovizive, lidhjet me internet, etj. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin mjaft modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit, instalimet e programeve dhe azhurnimet e</p>



zhvillimin e praktikave profesionale.	<p>tyre bëhen në kohë reale.</p> <p>UNYT garanton mbarëvajtjen dhe mbështetjen logjistike dhe me bazë materiale në realizimin e kërkuar sasior dhe cilësor të programit. Sa i takon praktikave profesionale, UNYT ka akomoduar një numër kërkesash të studentëve për të zhvilluar praktikën në njësi të ndryshme administrative si: Bibliotekë, Zyrën e Kujdesit ndaj Studentëve, Zyrën e Karrierës dhe Praktikave, Zyrën e Aktiviteteve, Zyrën e IT-së, pranë koordinatoreve të Departamenteve. Megjithatë pjesa më e madhe e kërkesave janë akomoduar në institucionet dhe kompanitë me të cilat UNYT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi .</p>
---------------------------------------	--

### **Konkluzione të GVJ:**

Në përputhje dhe zbatim të metodologjisë së vlerësimit, GVJ konsideron se UNYT ka krijuar logjistikë funksionale dhe mjedise pune të përshtatshme si për pedagogët dhe studentët. Ai garanton dhe pasuron vazhdimisht bazën materiale për realizimin e kërkuar sasior dhe cilësor të programit. Kjo pasqyrohet në të gjitha drejtimet e infrastrukturës si dhe evidentohet qartazi nga treguesit e matshëm.

GVJ gjithashtu konstaton se mirëqenia e stafit akademik dhe e studentëve është gjithashtu e konsideruar si aspekt i veçantë, që i tejkalon kufijtë e interesit të procesit mësimor. Me zhvendosjen në godinën e re të UNYT, studentët dhe personeli akademik kanë mundësinë të gëzojnë një ambient të shëndetshëm dhe të këndshëm. Çështja e transportit dhe e parkimit, e konsideruar si kritike për përfaqësuesit e studentëve, gjithashtu është zgjidhur në mënyrën më efektive të mundshme.

## **5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

### **Pjesa përshkimore**

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

GVJ konstaton se UNYT ka marrë të gjitha masat e nevojshme për një menaxhues me efektivitet burimet financiare si edhe pasqyruar në mënyrë korrekte mënyrën e përdorimit të tyre. Zyrë e Financës është e paisur me personelin e duhur dhe rezulton të ketë kapacitete të mjaftueshme për të realizuar detyrat e saj si edhe garantuar përdorimin korrekt të burimeve.

Procedurat operacionale dhe financiare janë gjithashtu të përcaktuara. Në këto procedura, dokumentimi i veprimeve ndjekin linjën e proceseve të miratua nga UNYT. GVJ gjithashtu konstaton se UNYT zbaton me korrektësi praktikën e kontabilitetit financiar, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

Gjithashtu, GVJ vlerëson se UNYT ndjek me vëmendje përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat i paraqiten Bordit të Administratës dhe personelit drejtues. Gjithashtu këto pasqyra shërbejnë për të monitoruar shpenzimet e buxhetit mbi baza aktuale dhe/ose krahasuese për të kuptuar më mirë ecurinë e problematikave financiare si edhe përgatitjen e parashikimeve për të ardhmen, për të mbështetur vendimmarrjen efektive të menaxhimit financiar.

UNYT zotëron kapacitetet e nevojshme për të zhvilluar sisteme dhe procese menaxhimi efektive financiare dhe për të përdorur informacionin financiar në mënyrë strategjike me qëllim që të mbështesë zhvillimin e programeve dhe analizën e kostove që të sigurojë qëndrueshmëri dhe vijueshmëri, të cilat janë jetike për një organizatë me zhvillim të qëndrueshëm. Drejtuesit e Institucionit i komunikuan GVJ se kapacitetet





financiare menaxhuese të UNYT bazohen në një sërë procesesh dhe dokumentash që UNYT zotëron, sikurse vijojnë:

- Ndjekja e procedurave të kontabilitetit në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.
- Përgatitja e pasqyrave financiare (bilancin, pasqyrën e të ardhurave, shpenzimeve, pasqyrën e fluksit të likuiditetit), të cilat ofrojnë informacion për bordin e aksionerëve, administratorin dhe stafin menaxhues.
- Përgatitja e një buxheti vjetor operacional të përgjithshëm i cili përfshin kostot për të gjitha programet e tyre, sikurse dhe pritshmëritë rreth gjendjes së përgjithshme financiare, të cilat kryesisht bazohen në të ardhurat nga tarifat e mësimdhënies. Ky buxhet miratohet nga Administratori i UNYT.
- Kryerja e monitorimit të buxhetit (aktual përballë parashikimit), me qëllim që të kuptojë më qartë mënyrën e ecurisë së financave.
- etj

Në fund të çdo viti akademik, UNYT kryen analizën e kostove të programeve të studimit. Analiza e kostove përmban: Kosto Operative: Kosto e mësimdhënies, udhëtimi dhe akomodimi për profesorët që udhëtojnë jashtë vendit, tarifat që ju paguhen universiteteve partnere (State University of New York/Empire State College, University of Greenwich, Institute Universitaire Curt Bosch), pagat e stafit mbështetës administrativ sikurse dhe kosto të tjera fikse operationale siç janë qeratat, energjia elektrike/telefon/internet etj, të cilat janë të lidhura me këto programe.

Shpenzime konstante: Kostot e blerjes së kapitaleve të prekshme (fizike) të nevojshme për zhvillimin e programeve akademike siç janë kostot për blerjen e kompjuterave dhe paisjeve IT, si edhe të aseteve të tjera si edhe kostot e aseteve jo-fizike siç janë shpenzimet për: blerjen e liçensave të programeve software, pagesa e tarifave të akreditimit të programeve, i liçensave të bibliotekave etj.

Kosto për një student në vitin 2016-2017 ishte €4,151, ndërsa një vit më parë ishte €3,915.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

GVJ analizoi tabelat e paraqitura në RVB të cilat sjellin informacion të detajuar mbi “Të ardhurat” dhe “Shpenzimet e Institucionit”. Informacioni dëshmon se:

- Të ardhurat janë ulur nga viti në vit, mesatarisht 6 deri 7%, gjë e cila është rrjedhojë kryesisht e uljes të të ardhurave nga “Tarifat e shkollimit” si edhe “Aktivitetete tregëtare”.
- Ndonëse “Të ardhurat” janë ulur, “Të ardhurat nga “Grantet për kërkim dhe kontratat” janë rritur.
- Përbërja e të ardhurave thuajse nuk ka ndryshuar.
- Kostot për një student janë rritur.
- Peshat specifike e pagave është rritur, e shpenzimeve është ulur.

Përkatësisht,

- Të ardhurat e përgjithshme në vitin 2017 janë 7% më pak se sa ato të një viti më parë, dhe 15% më pak se sa të ardhurat në vitin 2015.
- Me të njëjtat ritme janë ulur të ardhurat nga tarifat e shkollimit.
- Të ardhurat nga “Grantet për kërkim dhe kontratat” janë rritur në krahasim me vitin 2014, rreth 8 herë.



- Rreth 95% të të ardhurave e përbëjnë të ardhurat nga tarifat e shkollimit, rreth 4% të të ardhurave e përbëjnë të ardhurat nga Grantet, ndërsa të ardhurat nga aktivitetet janë të konsiderueshme (më pak se 1%). Në krahasim me periudhat e mëparshme, këto të ardhura janë ulur ndjeshëm.

Ndonëse informacioni mbi buxhetin dhe financat është i pamjaftueshëm për të bërë analizë të thelluar, mund të tërhiqet vëmëndja në dy drejtime, si vijojnë:

- Në kushtet e ndryshimit të pronësisë mbi aktivitetin, situata financiare mund të përkeqësohet për shkak të mundësisë të ndryshimit të perceptimeve të tregut dhe të publikut.
- Kosto e lartë e studimeve për një student, mund të ndikojë në uljen e numrit të studentëve në të ardhmen.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Shpenzimet për një student kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit. Në vitin 2016-2017, shpenzimet për një student janë rritur 6% në krahasim me një vit më parë. Në përgjithësi shpenzimet për paga janë rritur, përkatësisht deri në 55% të shpenzimeve, ndërsa shpenzimet e investimit përbëjnë 2 deri 4 % të shpenzimeve të përgjithshme.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstatoi se: Institucioni bën një auditim të përvitshëm të situatës financiare të tij</p> <p>Për secilin vit akademik institucioni harton raportin në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standardeve.</p>
<b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b> <b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>UNYT ka raport auditit çdo vit. Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse, shfrytëzimin dhe eficientësinë e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimeve shkencore për studentët. Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike.</p> <p>Institucioni dëshmon qëndrueshmëri financiare. Gjithsesi konstatohet se të ardhurat janë zvogëluar nga një vit në tjetrin, kryesisht për efekt të zvogëlimit të të ardhurave nga tarifat e shkollimit, ndonëse të ardhurat nga projektet e zhvillimit janë rritur ndjeshëm.</p> <p>Gjithashtu shpenzimet për paga janë rritur, përkatësisht deri në 55% të shpenzimeve, ndërsa shpenzimet e investimit përbëjnë 2 deri 4 % të shpenzimeve të përgjithshme.</p>



### Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ, në përfundim të shqyrtimit të RVB, të dokumentacionit të ofruar nga institucioni si edhe pas diskutimeve me personelin përkatës, konfirmon se UNYT ka organizuar mbajtjen e rregullt të të dhënave financiare të institucionit. Dokumentacioni mbi të ardhurat dhe shpenzimet është i rregullt dhe provohet edhe nga rezultatet e kontrolleve periodike, të cilave iu është nënshtruar institucioni. Gjithsesi, **GVJ konstaton se:** Situata financiare e institucionit, ndonëse paraqitet e qëndrueshme, mund të përballlet me dy rreziqe, të cilat mund të vijnë për shkak të ndryshimit të menaxhimit të të gjithë institucionit dhe mënyrës me të cilën ky ndryshim do të perceptohet nga tregu, si edhe për shkak të ndryshimit të adoptuar së fundmi në Programin Bsc Administrim Biznesi, që ende nuk është përthithur nga tregu.

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

GVJ, mbështetur në RVB por edhe gjatë takimeve në IAL me NJSBC, vëren se: Sigurimi i brendshëm i cilësisë në institucion bëhej i mundur përmes ngritjes dhe vënies në funksionim të disa mekanizmave si:

- Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë i cili është institucionalizuar si strukturë organizative në UNYT nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të strukturave të përhershme;
- Përmes Komisionit për Garantimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit (KGSC) i cili siguron dhe monitoron cilësinë e mësimdhënies në bashkëpunim me Koordinatorin e Sigurimit të Cilësisë. KGSC zgjidhet nga Senati Akademik siç parashikohet në Statutin e UNYT. KGSC është përgjegjës për koordinimin e procedurave të përgjithshme për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të njësive akademike dhe mbështetëse të studentëve që garantojnë përputhshmërinë me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar duke siguruar një përmirësim të cilësisë së vazhdueshme në UNYT në bashkëpunim me të gjithë partnerët institucional të saj. Një dokument bazë i përdorur nga kjo njësi është Manuali për Sigurimin e Cilësisë. Njësia e Sigurimit të Cilësisë (Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit – KGSC) përbëhet nga 7 anëtarë. Këta anëtarë janë në këtë detyrë që nga Nëntor 2016-Prill 2018.

Bazuar edhe në takimet me drejtuesit e njësive së sigurimit të cilësisë por edhe me drejtues të njësive bazë dhe të fakultetit përkatës, GVJ konstatoi se Institucioni për të dhënë vëmendjen e duhur ngritjes së standardeve të cilësisë bazohet në disa dokumenta strategjike si: Strategic Plan UNYT2012-2017, Strategic Plan UNYT 2018-2022.

Kushtet që kanë krijuar mundësi dhe optimizuar sigurimin e cilësisë janë pikërisht praktikatat më të mira të partneriteteve institucionale të krijuara që nga fillimi, me Empire State College gjë e cila ka garantuar procedurat e Sigurimit të Cilësisë të zbatuara nga UNYT.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët
  - Sa studentë janë anketuar
  - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
  - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
  - Etj



Proçesi i vetëvlerësimit i kthyer tashmë në një standard të përvitshëm për drejtuesit e njësive të sigurimit të cilësisë dhe stafit mbështetës, është një proces me disa hallka (komentet për përmbushjen e standardeve janë dhënë në tabelën e mëposhtme). Ky proces koordinohet nga Asistentja e Rektorit në bashkëpunim me Koordinatorin e zyrës së sigurimit të cilësisë.

Përgjigjet analizohen dhe rezultatet ndahen me Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit, Dekanin e fakultetit dhe Rektoratin, duke ruajtur fshehtësinë për të shmangur konfliktin e interesit. Rezultatet e vlerësimit përbëjnë bazën e analizës së ecurisë që realizohet në departament si edhe të sigurimit të cilësisë.

Nuk ka informacion se sa anketime janë bërë nga studentët. Këtë informacion, si edhe analizën cilësore të të dhënave, mbi problemet që kanë rezultuar nga anketimet ose edhe se cilat kanë qenë hapat që institucioni ka planifikuar për të eliminuar shkaqet e problemeve, nuk pasqyrohen në tabelën 12.6 të ofruar nga institucioni.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Nga takimet në institucione me drejtues të njësive të sigurimit të cilësisë, por edhe me drejtues të njësive bazë (departament dhe fakultet), si dhe drejtuesja e ekipit të raportit të RVB kanë siguruar se strategjitë, planet kërkimore, objektivat që kanë departamentet si njësi, dhe ato individuale, si dhe analiza në fund të vitit janë disa tregues që konfirmojnë mbështetjen e vazhduar në standardet e cilësisë.

Përfshirja e institucionit në projekte me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë (si p.sh projektin Erasmus+ QainAL "Mbështetja strategjike për forcimin e strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri", i cili kishte si fokus të krijimin dhe mbështetjen e proceset për sigurimin e cilësisë dhe mekanizmat për të siguruar menaxhim efektiv dhe për të përmirësuar mësimdhënien), është konsideruar nga drejtuesit e rëndësishme për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënie si dhe për mbështetjen e proçeseve të sigurimit të cilësisë. Kësaj i shtohen edhe trajnimet që stafi ka bërë.

Nga vizita në institucion, diskutimet me drejtuesit e njësive bazë dhe dokumentacioni rezultoi se sfidat me të cilat përballet ky institucion, që kanë të bëjnë jo vetëm me krijimin dhe ruajtjen e standardeve, por edhe me riorganizimin e ri të këtij programi, kërkojnë nevojën e një platforme të re, të gjerë dhe ndërvepruese të sigurimit dhe ruajtjes së cilësisë. Përveçse një projekti që siguron mbështetjen apo trajnimet e stafit, konferencës që është bërë në 2015 (orë jo në mënyrë të rregullt dhe të shpërndarë në kohë), institucioni duhet të shtojë instrumentat për sigurimin e cilësisë dhe të matjes së saj.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Dokumentat që mbështesin vlerësimin e cilësisë janë: "Students evaluation Form"; "Peer Evaluation Form"; "Formulari i Performancës së Vlerësimit Individual" si edhe "Forma e Raportit Vjetor të Departamentit".

GVJ konstaton se UNYT investon në rritjen e cilësisë, gjë e cila demonstron nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm dhe kontrollit të cilësisë, nëpërmjet monitorimit të aktivitetit akademik dhe mësimdhënies të personelit akademik. Në këtë kontekst, si vlerësimet e studentëve, ashtu edhe të kolegëve, shërbejnë për të nxjerrë përfundime që kanë të bëjnë me ecurinë e përgjithshme të programit si edhe të procesit të mësimdhënies.

GVJ konsideron praktikë të mirë pune mbledhjen e raporteve dhe formularëve të vetëvlerësimit nga Shefi i Departamentit si edhe analizën e tyre me qëllim nxjerrjen e përfundimeve mbi cilësinë e programit të ofruar në UNYT.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Përgjegjësitë e Kontrollit të Brendshëm të Cilësisë janë të rrisin dhe zhvillojnë sistemin e garantimit të Cilësisë në përputhje me misionin dhe kërkesat kombëtare të institucionit. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe Koordinatori i Sigurimit të Cilësisë, në bashkëpunim me Dekanët e



Fakulteteve, Drejtorët e Departamentit që mbulojnë Programin janë përgjegjës për çështjet e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.

Politikat e përmirësimin të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Bazuar në të dhënat nga dosja e vetëvlerësimit, gjendja në institucion synon të përafrojë sa më shumë drejt standardeve cilësore dhe imazhit që UNYT ka në tregun e arsimit të lartë. Rishikimi i standardeve dhe procedurave të sigurimit të cilësisë për periudha të rregullta si dhe dorëzimi i tyre tek Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe të Senatit për ndryshime të mundshme përbëjnë një praktikë të mirë drejt përmirësimin të cilësisë. Kjo është konfirmuar edhe përgjatë diskutimeve me drejtuesit e njësive përkatëse.

Evidentojmë se nga gjendja e konstatuar në Institucion gjatë vizitës krahasuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (DVV) për këta tregues nuk ka ndryshime të dukshme, por ka vend për përmirësime, si psh përfshirjen e stafit në kërkim dhe përdorimin e kësaj si tregues të cilësisë në mësimdhënie; përfshirjen e alumni në procesin e kontrollit dhe vlerësimit të cilësisë, mbështetje në më shumë projekte që synojnë përmirësimin e cilësisë së strukturave të sigurimit të cilësisë, ndarjen e eksperimenteve me institucionet si motra brenda dhe veçanërisht jashtë vendit, organizimin e eventeve dhe tryezave të rumbullakëta me institucione të tjera të arsimit të lartë apo kërkimore/politibërëse për çështje të tilla, etj

Këto përmirësime do të mund të mbështesin në të ardhmen një riorgaizim të mirë orientuar të programit përkatës.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Shembull i formularit të vlerësimit të studentëve.
- Formularë të vlerësimit të kolegëve.
- Formular i Performancës të Vlerësimit Individual.
- Raporti Vjetor i departamentit.
- Raporti i Paanshmërisë, Transparencës.
- Tabela e Vlerësimeve të profesorëve nga studentët.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</p>	<p>Institucioni bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion por edhe në takimet dyditore me grupet e ndryshme, rezulton se ka një qasje pozitive drejt cilësisë. Për këtë synon të përafrojë me metodologji vlerësimi apo synon drejt përdorimit të instrumentave dhe treguesve matës.</p> <p>Nga takimet në institucione me drejtues të njësive të sigurimit të cilësisë, por edhe me drejtues të njësive bazë (departament dhe fakultet), si dhe nga takimi me stafin u konfirmua se përdorimi i vetëvlerësimeve, i kthyer tashmë në një proces të përvitshëm, është konsideruar si instrumenti kryesor</p>



<p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <p>a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Vlerësimi me nota/pikë;</p> <p>d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</p> <p>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>	<p>i cili siguron një informacion të plotë mbi atë çka perceptojnë dhe gjykojnë studentët. Megjithatë, nga vetë drejtuesit është konsideruar nevoja për më shumë raporte apo të dhëna sasiore apo dokumentacion për vlerësimin e pedagogëve. Ka edhe një dokument të ri në nivel fakulteti që tregon vlerësimin me pikë të pedagogut. Por ky është sistem i ri, për rrjedhojë është ende e pamundur që të analizohen të dhëna efektive.</p> <p>Nga të njëjta diskutime rezultojnë se ndër aspektet që do të përmirësonin këtë proces është pikërisht menaxhimi i tij nga një numër më i madh dhe cilësor stafi, me qëllim që një proces kaq delikat të mos menaxhohet në mënyrë individuale.</p> <p>Në aneksin 12.6. që paraqet tabelën e vlerësimeve të profesorëve nga studentët, nuk reflektohet një analizë cilësore e rezultateve, si për shembull se çfarë problemesh janë evidentuar, por është paraqitur vetëm një përmbledhje e disa përgjigjeve.</p> <p>Por grupi i ngritur nga rektorati që monitoron procesin siguron cilësinë e mbarëvajtjes së këtij procesi. Nga diskutimet në terren ka rezultuar se mbi bazën e këtyre formateve vlerësimi janë bërë disa përmirësime.</p> <p>Të tjera metoda vlerësimi të konstatuara jo vetëm nga dokumentacioni por edhe në terren konfirmohen: vlerësimet e studentëve për kursin, vlerësimet e kolegëve për njëri tjetrin, formën e vlerësimit të performancës individuale të profesorëve, raportet vjetore të mësimdhënies, të nxënies dhe standardet përkatëse të cilësisë të përpiluara nga departamenti në fund të vitit akademik.</p> <p>Auditimi dhe vlerësimi i jashtëm nuk është aplikuar për këtë program.</p>
---	---

**VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË**  
**Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në</p>	<p>Nga diskutimet dhe informacionet e marra në institucion, si dhe nga raportet e vëna në dispozicion, vihet re një ndërgjegjësim jo vetëm i stafit akademik, studentëve, por në të gjitha nivelet jo vetëm drejtuese. Ndërgjegjësimi drejt cilësisë përbën një standard cilësor të dukshëm dhe të rëndësishëm. UNYT përbën IAL e parë të akredituar plotësisht në 2006, riakredituar më vonë në 2017. Për të mbajtur këto nivele, por jo vetëm për këtë arsye, UNYT përdor instrumentat e duhur për sigurimin e cilësisë si psh Manuali i Sigurimit të Cilësisë që është instrument institucional bazë për Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit. UNYT përdor mekanizmat formale për rishikimin periodik, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve studimore, siç janë rishikimi i planit mësimor nga kreu i departamenteve, në bazë të</p>
--	---



to;

**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

zhvillimeve të institucionit, kërkesave ligjore dhe nevojave të tregut. Gjithashtu aplikohet edhe një mekanizëm rishikimi periodik të kurrikulës i cili miratohet nga Senati.

Instrumenta të tjerë që janë përdorur janë: vlerësimet e studentëve, liria drejt përdorimit të peticioneve, vlerësimet e pedagogëve nga supervizorët. Nga takimi me studentët rezultoi se jo gjithnjë ata janë të përfshirë në të gjitha hallkat dhe se do të dëshironin të ishin më aktivë dhe të kishin më shumë informacion. Kjo do të bënte të mundur sigurimin e cilësisë në hallka të ndryshme të vendimarrjes.

UNYT ka hartuar dhe zbaton Strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, e cila është e aksesueshme.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion por edhe në takimet dyditore me grupet e ndryshme, rezultoi se ka një qasje pozitive drejt cilësisë. Për këtë qëllim, institucioni synon të përafrojë me metodologji vlerësimi apo synon drejt përdorimit të instrumentave dhe treguesve matës.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë, janë institucionalizuar në dokumentat dhe politikat e institucionit, ndërsa të gjithë aktorët janë informuar. Për të mbështetur sfidat me të cilat përballet ky institucion, që kanë të bëjnë jo vetëm me krijimin dhe mbajtjen e standarteve, por edhe me riorganizimin e ri të këtij programi, **rekomandojmë** në të ardhmen nevojën e një platforme të re, të gjerë dhe ndërvepruese të sigurimit dhe mbajtjes së cilësisë, të shoqëruar me tregues konkretë për matjen e këtij treguesi.

## **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Mbështetur në RVB, Ekspertët e vlerësimit shprehën se: Misioni i UNYT është përgatitja e udhëheqësve të ardhshëm nëpërmjet mësimdhënies, të të nxënit dhe hulumtimit duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit personal dhe influencës në komunitet, duke siguruar njohuritë, aftësitë, moralin dhe besimin e nevojshëm për të patur sukses në një mjedis heterogjen, ndërkombëtar. Ky program u ndërtua me idenë e tërheqjes së një segmeti tregu i cili kishte nevojë për një mësimdhënie dhe program nga i njëjti institucion por në gjuhën shqipe.

Ky program rregullohet nëpërmjet rregullores së posaçme të programit (Aneks 3: Rregullore e Programeve Bachelor në Gjuhën Shqipe). Programi ofrohet nga Departamenti i Administrimit të Biznesit dhe drejtohet nga Bordi i Programit (Aneks 23: Bordi Bsc në AB dhe kompetencat). Përdoren një larmi metodash vlerësimi dhe testimi formative dhe akumulative (Aneksi 2.1: Syllabuset), të cilat informojnë procesin e mësimdhënies. Të tilla janë diskutime në klasë, provime të shkruara (brenda ose jashtë klasës me libra të hapura apo jo), ese kërkimore, bibliografi të anotuara, dizenjimi kërkimi dhe prezantime gojore, individuale apo në grupe.

Vlerësimi lidhet me qëllimet dhe objektivat e programit të studimit dhe informon procesin mësimor.



Programi i studimeve Bachelor në Administrim Biznesi realizohet me "jo më pak se 180 kredite dhe me kohëzgjatje normale 3 vjet dhe forma e studimit është me kohë të plotë. Çdo program mësimor analizohet nga shefi i departamentit dhe në formën e tij përfundimtare i dorëzohet për aprovim Këshillit të Cilësisë. Në orën e parë të lëndës, programi ju jepet studentëve për t'u njohur me të dhe për ta diskutuar. Në program studentëve u jepet informacion i mjaftueshëm për kohën se kur mund të kontaktojnë pedagogun, për objektivat si dhe qëllimin e lëndës, përmbajtjen dhe kërkesat e saj. Në program, studentëve gjithashtu u jepen detaje mbi mënyrën e vlerësimit si dhe normat e sjelljes.

Programi mësimor funksionon si një kontratë pune ndërmjet studentit dhe pedagogut. Ai përfshin përmbajtjen e lëndës, përcaktimin e qartë të kriterëve të vlerësimit dhe detyrimet e studentit. Elementët kryesorë të mësimin janë: leksionet, detyrat e kursit, projektet e kursit, praktikat profesionale, punë laboratorike, esetë, provimet, provimet e formimit, temat e diplomës etj.

Stafi i angazhuar për mësimdhënie në këtë program është i kualifikuar dhe kryesisht me eksperiencë ndërkombëtare (Aneksi 2.2: CVs). Gjithashtu profesorë që vijnë nga industria dhe bota e biznesit janë angazhuar në mënyrë që t'ju ofrojnë studentëve ndërthurje të njohurive akademike me ato praktike. Të dhëna të detajuara mbi numrin e stafit të angazhuar në program dhe gradat shkencore janë pasqyruar në tabelat në vijim (pika 2 dhe 3 e këtij raporti). Literatura dhe materialet e tjera mbështetëse zgjidhen duke ju referuar kohës kur janë botuar, kredibilitetit të autorit dhe të përkthyesit si dhe nivelit të shtëpisë botuese përkatëse. Tekstet e përzgjedhura miratohen nga shefi i departamentit para çdo fillimi të vitit akademik. Gjithashtu koordinatori e programit bën projeksionet për literaturën e nevojshme dhe porosinë në bibliotekën e shkollës (Aneks 24.1: Plani i Librave të Bibliotekës BA).

Bazuar edhe në opinionet e drejtuesve të njësive bazë, pamjaftueshmëria e literaturës në gjuhën shqipe përbën një pikë të dobët, sikurse konstatohet edhe nga studentët e këtij programi, krahasuar me ata të gjuhës angleze që kanë në dispozicion të tyre një larmishmëri titujsh nga biblioteka online dhe "hard copy" në bibliotekën e institucionit.

Nga analiza e të dhënave të Dosjes së vetëvlerësimit si dhe nga vizita në institucion dhe dokumentacioni i paraqitur rezultoi se ka një vijim normal dhe të strukturuar të organizimit të programit dhe mbarëvajtjes për ta monitoruar dhe manaxhuar në mënyrën e duhur. Nuk ka ndryshime që mund të çenojnë përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi Bachelor në Administrim biznesi filloi vitin e tij të parë akademik në vitin 2013, pas një studimi marketingu (Aneksi 4 : Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit) për të analizuar nevojat e tregut të punës në këtë degë. Ai u liçensua me Urdhër të Ministrit Nr. 268, datë 28.06.2013 "Për hapjen e programeve të reja të ciklit të parë të studimeve Bachelor në "Financë", "Administrim Biznesi", "Sisteme të Informacionit", të Universitetit privat "Universiteti i New York-ut në Tiranë (New York University of Tirana)". **Programi nuk ka qënë aktiv në tre vitet e fundit akademike (2015-2018)**

Ky program rregullohet nëpërmjet rregullores së posacme të programit (Aneks 3: Rregullore e Programeve Bachelor në Gjuhën Shqipe). Programi ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit dhe drejtohet nga Bordi i Programit (Aneks 23: Bordi Bsc në AB dhe kompetencat).

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik përmban 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër përmban 15 javë mësimore në auditor

Planet mësimore, ku të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (plani mësimor i tre viteve ne aneks)

- 1 ECTS = 22.5 orë mësimore pune të studentit



- 1 orë mësimore = 60 minuta

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Programi i Studimit Bsc ne Administrim Biznesi	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	450
Seminare	450
Ushtrime	450
Laboratore	90
Praktikë lëndore	2430
Praktikë profesionale	180
Etj	-
Në total	4050

Nuk janë paraqitur të dhëna për ngarkesën jashtë auditorit.

Format e studimit (leksione, seminare, laboratore, etj janë të integruara dhe ndarja e tyre është kompetencë e instruktorit të lëndës. Kurset me 6 kredite përmbajnë 45 orë në auditor dhe 90 orë të tjera punë të pavarur të studentit, ndërsa Projektit Final me 16 kredite i përkushtohen 30 orë në auditor dhe 330 orë punë të pavarur nga studenti.

Për të marrë titullin bachelor nevojitet përmbushja e 180 krediteve akademike.

- 7.5 orë në klasë dhe për 15 -23 orë përmbi këto me punë të pavarur nga studenti, për lëndët që i përkasin tipeve të veprimtarisë A, B, C, dhe D (Aneks 3, neni 32: Rregullore e Programeve Bachelor në Gjuhën Shqipe,);
- 1.9 orë në auditor dhe 20.6 orë punë e pavarur e studentit, për lëndët që i përkasin tipit të veprimtarisë F (Teza e Diplomës, Aneks 2.4).

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Shiko Anekse, tabela12)

Ndryshimet konsistojnë në ndryshimin e ofrimit të lëndëve në vite dhe semestra të ndryshëm. Janë shtuar dy lëndë (Anglisht I dhe II). Biznesi Ndërkombëtar u ndryshua në Lëndë Elektive duke u ofruar në V.III, semestri i parë dhe për pasojë u hoq lënda Elektive në semestrin e II duke u kompesuar me kreditet e gjuhës së huaj. Në total, ndryshimi në kredite rezultojnë në 6 kredite ECTS shtesë.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Anekse, Tabela 13)

Të dhënat sipas PAE dhe PAK për vitin 2017-2018 mungojnë. Ndërsa gjatë periudhave të mëparshme, që nga 2013 – 2014 deri 2016 – 2017 rezultojnë se janë zhvilluar gjithsej 2620 orë në auditor, prej të cilave 2290 orë janë zhvilluar nga stafi akademik PAE dhe 330 orë janë zhvilluar nga stafi akademik PAK. Stafi akademik PAE mban peshën kryesore në realizimin e programit akademik, përkatësisht me zhvillimin e 87% të orëve në auditor .

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda



- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetësimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analiza e cilësisë së syllabuseve

Edhe nga analiza në terren (si nga takimi me stafin) ashtu edhe nga dokumentacioni rezultoi se institucioni i kushton vëmendje të veçantë si formës ashtu edhe përmbajtjes së syllabusave. Nga takimi me stafin akademik rezultoi se kanë liri akademike jo vetëm në përditësimin e literaturës, por edhe në rregullimin e syllabuseve brenda formës së strukturuar të kërkuar. Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin Bachelor në Administrim Biznesi janë të hartuara në shqip dhe anglisht. Shefi i departamentit dhe koordinatori e programit miratojnë versionin përfundimtar të çdo lënde para fillimit të vitit akademik. Të gjitha syllabuset japin informacion të detajuar mbi mënyrën e mësimdhënies, elementët e vlerësimit të studentëve, literaturën bazë dhe atë të sugjeruar, etj, duke ofruar informacion të detajuar për studentët dhe duke plotësuar kriteret e mësipërme. Nga takimi me drejtuesin e fakultetit rezultoi se institucioni e ka si praktikë kryerjen dhe përditësimin e kurrikulave, por nuk është bërë kjo për programin në gjuhën shqipe. Ndërsa për programet e tjera që kanë filluar më parë është bërë rishikim i kurrikulës.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin si dhe takimet e realizuara, GVJ konfirmon se UNYT në këtë program studimi ndjek vlerësimin në ECTS të moduleve mësimore. Sasia mesatare e krediteve është së paku 60 ECTS për vit akademik. Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara qartë (të përmendura më lart) të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe karakterizojnë profilin e programit. Të gjithë programet e studimit konceptohen dhe hartohen në bazë të misionit të UNYT. Studenti duhet të likuadojë gjatë një viti jo më pak se 60 kredite..</p>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p>	<p>GVJ konstatoi se organizimi i dhënies së informacionit tek studentët në lidhje me programin e studimit, syllabuset dhe elementët e tjerë të formës e përmbajtjes së një programi studimi ofrohen në mënyrë të rregullt dhe të organizuar brenda institucionit.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni i paraqitur, rezultoi se ka një vijim normal dhe të</p>



**Kriteri 3** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit;

**Kriteri 4** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

strukturuar të organizimit të programit dhe mbarëvajtjes për ta monitoruar dhe manaxhuar në mënyrën e duhur. Për shembull Koordinatorja e Programit bën projektimet e lëndëve për çdo semester të cilat miratohen në Departament dhe më pas në Dekanat. Këto projektme japin informacion edhe për lëndët me zgjedhje dhe të detyruara.

Shefi i Departamentit në bashkëpunim me Koordinatorën e Programit dhe zyrën e rekordeve evidenton ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin e programit nga studentët si edhe orët faktike të realizuara nga instruktori i lëndës. Koordinatorja e Programit në koordinim me Departamentin e Administrimit të Biznesit japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

GVJ, mbështetur në rezultatet e diskutimeve gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacioni i paraqitur, konkludon se ka një vijim normal dhe të strukturuar të organizimit të programit dhe mbarëvajtjes për ta monitoruar dhe manaxhuar në mënyrën e duhur.

Organizimi i dhënies së informacionit tek studentët në lidhje me programin e studimit, syllabuset dhe elementët e tjerë të formës e përmbajtjes së një programi studimi ofrohen në mënyrë të rregullt dhe të organizuar brenda institucionit.

Edhe nga analiza në terren (si nga takimi me stafin ashtu edhe nga dokumentacioni rezulton se institucioni i kushton vëmendje të veçantë si formës ashtu edhe përmbajtjes së syllabusave.

## **8. Mësimdhënia**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësive etj.

GVJ konstaton se UNYT trajton me përparësi sigurimin e standardeve të larta të mësimdhënies nëpërmjet harmonizimit të komponentëve teorikë dhe praktikë. Konstatohet se UNYT nxit dhe mbështet forma inovative të mësimdhënies, në qendër të të cilave është studenti. Kjo pasqyrohet në radhë të parë në lirinë krijuese të stafit akademik, në funksion të rritjes së efektivitetit të mësimdhënies.

GVJ konsideron mjaft efikase praktikën e ndjekur nga stafi akademik të organizimit të procesit mësimor në mënyrë pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse, e cila ndihmohet edhe nga kombinimi i përshtatshëm ndërmjet orëve të leksionit dhe të seminareve. Në funksion të mësimdhënies cilësore është edhe literatura e gjerë dhe e larmishme që studentët mund të disponojnë si nëpërmjet teksteve kryesore ashtu edhe atyre ndihmëse.

Si në çdo institucion akademik, ndjekja e rregullt e programit mësimor është e detyrueshme, me një nivel pjesëmarrje përkatësisht 80% për secilin modul. Megjithatë, GVJ konsideron matjen e pjesëmarrjes të pamjaftueshme për të vlerësuar Cilësinë e të Nxënës. Për këtë qëllim, GVJ, bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe nga shpjegimet e stafit akademik, arriti në përfundimin se cilësia e të nxënës monitorohet dhe vlerësohet me metoda përkatëse gjatë çdo seance, moduli dhe në fund të çdo lënde. Në përgjithësi, pavarësisht ndryshimeve ndërmjet lëndëve të ndryshme, vlerësimi bazohet tek pjesëmarrja, kontrolli i njohurive në mes të semestrit dhe në përfundim të tij, si edhe nëpërmjet hartimit dhe realizimit të një detyre ose projekti kërkimor.



Nga vizita në institucion, diskutimet me drejtuesit e njësisive bazë, stafin akademik, por veçanërisht edhe me studentët rezultoi se ka hapësira për të rritur cilësinë e mësimdhënies. Megjithëse ka një dokumentacion bazë dhe orientues, si dhe sisteme kontrolli nga Rektorati apo Dekanati, kërkohet nga studentët një përfshirje më aktive e tyre si dhe nevojë për më shumë internshipe, më shumë raste studimi konkrete nga biznese shqiptare ku të analizohen histori sukcesi apo dështimi, me qëllim që mësimdhënia të nxisë edhe elementët aktivë sipërmarrës dhe inovativ tek studentët.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

GVJ gjykon që UNYT përdor larmishmëri formash të mësimdhënies, me qëllim që të garantojë cilësinë më të mirë të mundshme si edhe efektivitetin e mësimdhënies. Leksionet dhe seminarët janë praktikë e zakonshme. Gjatë leksioneve dhe seminareve, përcimi i mesazheve ilustronet nëpërmjet ushtrimeve dhe atje ku aplikohet, përdorimi i laboratoreve.

Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive ndryshojnë nga lenda në lende, tabela në vijim paraqet një shembull tipik të aplikimit të këtyre formave. Marrë nga Syllabusi i lëndës “Manaxhimi i Projekteve” e dhënë në semestrin V 2015.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Bazuar edhe në opinionet e drejtuesve të njësisive bazë, literatura në gjuhën shqipe përbën një pikë të dobët, sikurse nuk është e mjaftueshme për studentët e këtij programi krahasuar me atë të gjuhës angleze që kanë në dispozicion të tyre një larmishmëri titujsh nga biblioteka online dhe hard copy në bibliotekën e institucionit.

Rezultoi nga takimi me stafin por edhe drejtues të tjerë (p.sh drejtuesi i qendrës kërkimore) të fakultetit, departamentit, etj, se ngarkesa e pedagogëve për një vit akademik është mjaft e lartë jo vetëm krahasuar me atë çka standardizon ligji i arsimit të lartë, por edhe me ngarkesën tjetër që lidhet me kryerjen e detyrave institucionale. E gjitha kjo sigurisht që mund të çënojë cilësinë e mësimdhënies, vështirëson profilizimin e pedagogëve. Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të mësimdhënies ka një përpjekje për të kryer vlerësime online nga studentët për pedagogët, por është ende për tu vlerësuar në të ardhmen. Ka përpjekje për të vendosur në qendër studentin dhe për ta përfshirë sa më shumë. Një formë është këshillimi akademik, nëpërmjet të cilit studentët përfshihen/aktivizohen në komponentët e aktivitetit të njësisë, ose përfshirja në forma të këshillimit të specializuar për mënyrën e kryerjes së obligimeve studentore. Përfshirja tek aktivitetet e qendrave mbështetëse si qendra e matematikës apo shkrimin akademik, janë gjithashtu forma të nxitjes së aktivizimit. Gjithsesi, studentët mbështesin idenë se kanë nevojë për më shumë internshipe, apo aktivitete që nxisin sipërmarrjen si “inkubatorët e biznesit” dhe “start up-et”, apo duan të jenë më të përfshirë në diskutimet dhe mbledhjet periodike të njësisë bazë. Por këto ndryshime nuk ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.



## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

GVJ konstaton se Programi Bsc në Administrim biznesi, si një program relativisht i ri, është karakterizuar nga një numër i ulët regjistrimesh dhe lëvizjesh po të tilla ( 10 studentë të rinj, 1 student i transferuar nga programet e ofruara në gjuhën angleze në UNYT). Ndonëse ecuria e regjistrimeve të reja dhe largimeve të studentëve paraqitet në Aneksin 26, *nënvizohet se nuk ka patur studentë të regjistruar për herë të parë në vitet akademike 2015-2016; 2016-2017; 2017-2018*. Gjithashtu, nga studentët e regjistruar në vitin akademik 2013 -2014 janë ç' regjistruar 6 studentë, ndërsa nga ata të regjistruar në vitin akademik 2014-2015 janë ç' regjistruar 5 studentë.

GVJ vlerëson përdorimin e "Rregullores së programit" si instrument ndihmës i ecurisë akademike, si edhe i rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet institucionit dhe studentëve, sidomos për çështje që lidhen me rezultatet e tyre në përparimin akademik (Aneks 3, Rregullorja e programeve Bachelor në gjuhën shqipe, nenet 58 "Riprovimet", 59 "Përmirësimi I notes" dhe 60 "Kriteret e mbartjes dhe ecurisë akademike").

Gjithashtu, konstatohet se rezultatet e studentëve, sipas të gjithë komponentëve mësimorë ruhen në "hard copy" dhe në bazën e të dhënave (elektronike), përveç edhe në të gjithë regjistrat e lëndëve. Koordinatorja e programit i kushton vëmendje mirëmbajtjes dhe ruajtjes të të dhënave si edhe hartimit të planit të edukimit të studentëve dhe kryen regjistrimin e tyre në fillim të çdo semestri. Gjithashtu, koordinatorja përgatit edhe statistikat për të pasqyruara kalueshmërinë dhe mbarëvajtjen e studentëve të programit (Aneks 28, "Grade Statistics"-Programi Shqip BA).

Zyra e Karrierës dhe Alumni (Career and Alumni Office) përgatit tabela që ilustrojnë aktivitete konkrete të cilave UNYT, studentët dhe ish-studentët krijojnë lidhje me komunitetin e biznesit (Aneks 20.4 Annual report 2015-2016, Tabela 7), ndërkohë që zyra e raporton progresin e saj vjetor tek Senati për t'a përfshirë në raportin e tij vjetor (Anekse 5.1 Strategic Plan, 2012-2017, Strategic Goal 5, Point 3). Zyra mban kontakt me bizneset në Shqipëri dhe në rajon (Anekset 22.1 dhe 22.2), me qëllim që t'u ofrojë mundësi punësimi dhe internship studentëve dhe ish-studentëve të UNYT, GVJ në vizitën në sekretarinë mësimore por edhe gjatë takimeve të tjera se, përse i përket punësimit të studentëve të diplomuar në këtë program, të dhënat nuk janë integruar ende nga duke qenë se akreditimi i programit është në process dhe studentët janë në pritje të diplomës së akredituar.

GVJ konstatoi se: UNYT mban kontakt të vazhdueshëm me studentët e të gjitha programeve në të gjitha ciklet e studimit. Ky kontakt kryhet si nga njësitë e ndryshme të institucionit ashtu edhe nga stafi, koordinatorët dhe pedagogët e lëndëve, sipas nevojës. Format e informimit janë të ndryshme. Në to përfshihet faqja web e UNYT ([www.unytedu.al](http://www.unytedu.al)), kryesisht tek "Menu" -"Events", rrjetet sociale (Facebook), posta elektronike (email), si edhe telefoni. Gjatë regjistrimit studentët e rinj i deklarojnë të dhënat e kontaktit, ku përfshihet adresa personale e emailit, numri i telefonit personal dhe numri i dytë i emergjencës. Këto të dhëna janë të ruajtura elektronikisht në sistemin e informacionit të UNYT, "Gnomon". Të dhënat bëhen të disponueshme për zyrat e ndryshme, stafin administrativ si edhe pedagogët e lëndëve. Tek ky sistem pedagogu i lëndës ka mundësinë të afishojë listën e të gjithë studentëve të regjistruar në atë lëndë, sëbashku me kontaktet e tyre, në mënyrë që t'i mbajë të informuar dhe t'u dërgojë materiale të ndryshme elektronike për lëndën e vet.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve



Vizita në institucion, diskutimi me personelin akademik dhe atë mbështetës, i realizuar sipas programit të ndërtuar paraprakisht, si edhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, konfirmoi rezultatet e RVB, përkatësisht:

- UNYT zotëron dokumentacion të plotë procedural mbi pranimin e studentëve (Aneksi 18.2, “Kriteret e pranimi në UNYT”, Ankes 3 “Rregullore e programit Bachelor në Gjuhën Shqip”).
- UNYT ka një zyrë të caktuar që kujdeset për zbatimin e procedurave të pranimi të studentëve, si për zbatimin e rregullave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, ashtu edhe për kriteret e përcaktuara nga Zyra e Pranimi të Studentëve (Aneksi 18.2, “Kriteret e pranimi në UNYT”).
- Procedura e pranimi realizohet duke respektuar parimet themelore të të drejtave të njeriut, në veçanti parimin e “Mos-diskriminimit”.
- Zyra e Pranimi mbledh dokumentacionin e aplikantëve, të cilin pasi e shqyrtton, e kategorizon dhe kërkon plotësim të tij, atëhere kur është e nevojshme dhe e mundshme.
- Zyra e Pranimi komunikon me të gjithë aplikantët të cilët informohen për vendimin.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Njësia bazë i kushton vëmendje regjistrimeve të reja në përgjithësi dhe cilësisë së studentëve në hyrje, në veçanti. UNYT organizon:

- Takim me shkollat e mesme, mbase me të gjitha shkollat e vendit, për të promovuar
- UNYT.
- Promovimin e UNYT nëpërmjet medias.
- Organizimin e “Open Day” me nxënës të shkollave të mesme.
- Aplikimin e bursave për studentë me rezultate të shkëlqyera si edhe bursa sociale, për studentë në nevojë. Aktivitetet e organizuara dhe të përshkruara më lart nuk synojnë vetëm tërheqjen e studentëve në UNYT, por edhe njohjen e tyre me programin, me aktivitetet, me stafin akademik si edhe me Strategjitë e UNYT në raport me cilësinë e mësimdhënies si edhe me promovimin e studentëve për zhvillimin e karrierës së tyre individuale. Megjithatë, siç tregon edhe tabela 17 në Aneks, nota mesatare e studentëve në hyrje është 7.5 deri 8. Për evidentimin e cilësisë së studentëve në përfundim të studimeve, evidencat janë të pamjaftueshme.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Referuar të dhënave në RVB, rezulton se në vitin akademik 2013-2014 janë regjistruar 10 studentë me notë mesatare 7.4. Në vitin akademik 2014-2015 janë regjistruar 9 studentë me notë mesatare 7.28

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Nuk ka të dhëna për këtë, pasi programi i studimit është në proces akreditimi

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Studentët e UNYT mund të aksesojnë cilido IAL në vend, përkundëjt zbatimit të procedurave të aplikimit. Gjithashtu UNYT pranon studentë nga institucione të tjera, nëse aplikimet e tyre janë në përputhje me Rregulloren e Pranimeve të UNYT. Megjithatë konstatohet mobilitet i ulët.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.	GVJ, në përputhje me metodologjinë e përzgjedhur, konstatoi se pranimi I studentëve në UNYT bëhet në përputhje të plotë me ligjin si



<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>edhe me procedurat Specifike të hartuara nga UNYT, të cilat janë paraqitur tek Rregullorja përkatëse.</p>
<p><b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p>	<p>GVJ si rrjedhojë e takimit me përfaqësues të Zyrës së Pranimeve dhe të karrierës, konfirmon se UNYT informon studentët me detaje dhe për gjithshka që ata janë të interesuar të njohin, në lidhje me programin, organizimin dhe çështje të tjera të cilat influencojnë jo vetëm ecurinë akademike të studentëve, por edhe raportet e tyre me tregun e punës.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p>	
<p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;  <b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	
<p><b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;  <b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;  <b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>GVJ, jo vetëm si rezultat i vizitës në institucion, por edhe si rezultat i shqyrtimit të dokumentacionit të UNYT, konstaton se statistikat e institucionit në lidhje me të regjistruarit, tërheqjet nga programi, ecurinë akademike të studentëve si edhe të diplomuarit, janë të plota dhe të detajuara.</p>
<p><b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;  <b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>GVJ, në përfundim të diskutimeve me punonjës të Zyrës së Karrierës si edhe me Drejtues të UNYT, konstaton se UNYT i kushton vëmendje të veçantë përkujdesjes ndaj studentëve. Numri i vogël i studentëve mund të konsiderohet si një avantazh i UNYT për të ofruar kujdesin më cilësor të mundshëm ndaj studentëve, jo vetëm në drejtim të këshillimit por edhe të ndërmjetësimit në tregun e punës.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p>	
<p>GVJ, pasi analizoi dokumentacionin përkatës, diskutoi me punonjësit dhe drejtuesit e ngarkuar për të ndjekur çështjet e sipërshënuara në këtë rubrikë, si edhe pas diskutimit me studentët, konstaton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni jo vetëm mbron të drejtat e studentëve gjatë periudhës në të cilën ata ndjekin studimet, por i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të karrierës, sidomos pas përfundimit të studimeve. Mbi këtë objektiv, është ndërtuar i gjithë aktiviteti akademik e social i UNYT.</li> <li>2. UNYT e realizon mbështetjen e tij ndaj studentëve, duke u mbështetur fuqimisht në evidenca dhe të dhëna, të cilat kanë të bëjnë me ecurinë akademike të studentëve, me njohjen e prirjeve dhe dëshirave të tyre, si edhe me udhëzimin për të ardhmen.</li> </ol>	






## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 10. Kërkimi shkencor

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

GVJ konstaton se institucioni është mbështetur tek Strategjia e Kërkimit 2014-2017, për të organizuar dhe vëzhguar kërkimin shkencor dhe rezultatet e tij. Si rezultat i politikës së organizuar të institucionit, nëpërmjet të cilës UNYT ka investuar në rritjen e kapaciteteve, burimeve dhe zhvillimin cilësor të metodologjive të kërkimit, si rezultat i së cilës, pjesa e stafit akademik e angazhuar në kërkim është rritur, ndërsa publikimet e prodhuara kanë qenë të një cilësie më të lartë.

GVJ konsideron përparësi mbështetjen e kërkimit shkencor ndërdisiplinor mes të gjithë njësive bazë, departamenteve e qendrave kërkimore dhe në partneritet me institucione të tjera kërkimore. UNYT ka përcaktuar fushat prioritare kërkimore mbështetur tek profili i institucionit, interesave kërkimore të stafit sikurse edhe prioriteteve kërkimore të tregut European të kërkimit. Në Aneksin 21.4 parashtrohen pesë shtyllat kërkimore me 16 projekte kërkimore tematike.

GVJ konstaton se 11 studentëve të programit Bachelor në Administrim biznesi ofruar në gjuhën shqipe janë të përfshirë në kërkim shkencor përmes punimeve të tyre të diplomës. Nga takimet në institucion por edhe bazuar në dokumentacion rezultojnë se në lidhje me aktivitetet e organizuara nga njësia, vetë stafi dhe drejtuesit ndjejnë nevojën e kërkimit në thellësi, më të orientuar drejt departamentit në formën e tryezave të rumbullakëta apo aktiviteteve të profilizuara shkencore të cilat mungojnë, apo një qasje më aktive ndaj përfshirjes së biznesit në to, apo nevojën për analiza të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë shqiptare, etj.

Njësia organizon edhe seminare zhvilluese, kryesisht me qëllim nxitjen e zhvillimit të personelit më të ri akademik, sidomos në drejtim të përmirësimit të metodave të mësimdhënies. Gjithashtu njësia mbështet stafin akademik me eksperiencë të hartojë plane individuale të kërkimit shkencor. Ndonëse kërkimi është individual, UNYT përpiqet që t'a institucionalizojë atë. Krijimi brenda UNYT i një organizate jo fitimprurëse (non profit) ka mundur aplikimin në projekte, gjë e cila ka dhënë rezultate të dukshme.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Nga dokumentat por edhe vizitat dy ditore në institucion u vunë re përpjekje të institucionit dhe drejtuesve të njësive kryesore për më shumë kërkim. Në lidhje me aktivitetet e organizuara nga njësia: vetë stafi dhe drejtuesit ndjejnë nevojën e kërkimit në thellësi, më të orientuar drejt departamentit në formën e tryezave të rumbullakëta apo aktiviteteve të profilizuara shkencore të cilat mungojnë, apo një qasje më aktive ndaj përfshirjes së biznesit në to, apo nevojën për analiza të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë shqiptare, etj. Imazhi dhe emri i mirë në treg i institucionit bëjnë të mundur dhe ofrojnë një bazë të qëndrueshme për mbështetjen nga projekte që forcojnë kërkimin, përmirësojnë mësimdhënien dhe i shërbejnë ekonomisë shqiptare. **Rekomandohet** përfshirje më e madhe cilësore dhe sasiore e studentëve në kërkim, jo vetëm me detyrat e tyre, projektet e kursit por me orientime dhe qasje më të forta drejt bashkëbërjes së projekteve/detyrave me stafet akademike në shërbim të tregut, duke bërë të mundur në këtë mënyrë lidhjen e kërkimit me mësimin. **Rekomandohet** (por mbështetet edhe nga drejtuesit e njësive bazë në institucione) se



brenda departamentit duhet të nxiten më shumë workshopet dhe eventet e profilizuara ku të përfshihen edhe studentët e bachelorit me detyrat e tyre apo pjesëmarrje në debate. Duhet të bëjnë konferenca/evente të profilizuara sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. **Rekomandohet** që kërkimi shkencor të orientojë e mbështesë promovimin e stafit akademik. Drejtues të njësive bazë argumentojnë se ekziston një dokument *promotion policy* ku janë vënë disa piketa se çfarë duhet të përmbushë stafi akademik për t'u promovuar më tej. Stafi është i promovuar në forma të ndryshme, por duam të formalizojmë/standardizojmë për ta bërë edhe më të matshëm. Por **këto ndryshime nuk ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.**

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Vihet re intensiteti i kërkimit nga një vit akademik në tjetrin, duke arritur në një total prej 18 publikime dhe 35 referime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithsesi këto të dhëna nuk rezultojnë të ndarë sipas viteve si edhe sipas departamenteve apo stafit akademik.

Numri i projekteve kërkimore të fituara

Numri i projekteve të fituara është 7. Në vitet e fundit, IAL është më i sukseshëm në tregun e projekteve, sepse ka ditur të kapërcejë pengesën ligjore, duke krijuar një OJF, e cila gëzon të drejtën e aplikimit. Universiteti ka intensifikuar përpjekjet për të marrë pjesë në projekte të financuara nga palë të treta dhe nga instrumentat e BE-së. Projekti "ADRIATIIC", në të cilin UNYT ishte partner, ishte një projekt rajonal "për të nxitur zhvillimin kërkimor dhe inovacionin në funksion të krijimit të politikave të reja për konkureshmëri të qëndrueshme dhe kapacitete teknologjike për SME-të. Ndërkohë, objektivat e projektit të Erasmus + mbi Sigurimin e Cilësisë ku universiteti është partner, janë për të ngritur dhe mbështetur proceset dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë në funksion të një menaxhimi, mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më efektive. Projekti është në përputhje me dy dokumenta politik kryesor të lidhur edhe me kërkimin: "Increasing the impact of EU development: an Agenda for Change" dhe "European Higher Education in the World" Modulet e Jean Monnet synojnë të zhvillohen në një fushë të pakërkuar ende si ligji mbi refugjatët, tema me potencial të madh për të ardhmen e afërt si rezultat i zhvillimeve në BE.

Numri i projekteve të zbatuara

Numri i projekteve të zbatuara është 3.

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

Universiteti ka organizuar tre konferenca, dy konferenca ndërkombëtare dhe një kombëtare si më poshtë:

- "Transition in Retrospect: 25 years after the fall of communism", Tirana, 27-28 Nëntor 2015.
- "International Conference on Labour Migration and Industrial Citizenship", Tirana, 13 Nëntor 2015.
- "First National Student Conference", Tirana, 27 Maj 2016.

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL

Më shumë se 200 pjesëmarrës kanë marrë pjesë në këto aktivitete.

Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

11 studentë kanë marrë pjesë në kërkimin shkencor.

Numri i Çmimeve Kombëtare

UNYT nuk ka marrë ndonjë çmim kombëtar.

Dokumentacioni mbështetës për këtë rubrikë

Aneksi 21.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor 2014-2017

Aneksi 21.4 UNYT Research Pillars



## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun


### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

GVJ konstaton se: Qasja ndaj kërkimit, mësimdhënies, rezultojnë në një përafrim të mundshëm të reflektuar në marrëdhëniet kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Institucioni ka dhe nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet aktiviteteve të vazhdueshme informuese dhe shkëmbimit të informacionit si pjesëmarrja në aktivitete dhe konferenca shkencore në forume ndërkombëtare dhe kombëtare. Zyra e Karrierës mban lidhje me komunitetin e biznesit, i cili është aktiv veçanërisht në panairin e përvitshëm të punësimit që UNYT organizon. Një pjesë e madhe e stafit akademik të UNYT të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Administrim Biznesi është trajnuar ndërkombëtarisht. Nevojat në fusha të ekspertizës të cilat nuk janë të mbuluara nga stafi me kohë të plotë i UNYT- mbulohen nga profesorët vizitues/ part time. Nga dokumentacioni por edhe nga vizita në institucion, dhe takimet me drejtues të fakultetit dhe veçanërisht të qendrës kërkimore vihet re se roli që kjo qendër mund të luajë në nxitjen e kërkimit shkencor, në forcimin e lidhjeve me bizneset/NGO/institucione lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, pra në rrjetëzimin e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimeve, është më i madh se sa ai aktual. Vihet re se infrastruktura në shërbim të kërkimit shkencor është mjaft e mirë dhe mbështetëse për punë individuale, por duhet të ketë politika që të tërheqi sa më shumë staf dhe studentë drejt përdorimit të tyre. Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit është pasiv. Roli i qendrës kërkimore duhet të forcohet dhe aktiviteti i saj duhet të bazohet dhe mbështetet në strategji dhe plane afatgjata. Studentët dhe stafi duhet të jenë pjesë aktive e përpilimit të planit të punës/aktiviteteve që mund dhe duhet të mbështesë kjo qendër. Qendra e kërkimit mbështet me ide departamentin për kërkimin, por do ishte mirë një nivel më i lartë i përfshirjes së stafit dhe studentëve në atë çka mund të jetë atraktive për kërkim, si ide apo nxitje për projekte duhet të përfshijë edhe departamentet apo alumni/student aktualë, qoftë edhe bizneset. Po kështu, edhe qendra e karrierës ka një rol të rëndësishëm këshillues me studentët, mbështet internshipin, përditëson databazën e bizneseve si dhe orienton drejt forcimit të punës me alumni.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
  - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare
  - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj
  - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit
  - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL
  - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
  - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime
- 3 punonjës të UNYT kanë marrë pjesë si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare, ndërsa 35 punonjës, staf akademik i UNYT, kanë marrë pjesë në aktivitete shkencore jashtë UNYT dhe jashtë vendit. Të gjithë pjesëmarrësit kanë prezantuar.
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
  - Institucionet qeveritare bashkëpunuese





- Organizatat Profesionale
- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

GVJ gjatë shqyrtimit të hollësishëm të RVB por edhe si konkluzion i vizitave të realizuara në periudhën dy ditore në Institucion, konstaton se:

- UNYT i ka kushtuar një rëndësi të veçantë bashkëpunimit me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit dhe formave të ndryshme të këtij bashkëpunimi, (mësimdhënie, kërkim shkencor, praktika mësimore, etj. (Tabela 22.2)
- UNYT ka një histori dhe eksperiencë të bashkëpunimit të tij me Institucione të tjera partnere akademike dhe shkencore të huaja. (Tabela 22.1)
- UNYT ka bashkëpunim nëpërmjet këmbimit të eksperiencave në aktivitete të përbashkëta dhe të veçanta me disa institucione qeveritare.
- UNYT bashkëpunon me komunitetin e biznesit,

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>GVJ vlerëson se ky institucion në bashkëpunimin e tij me institucionet brenda dhe jashtë vendit ka qenë i kënaqshëm në kontekstin e të gjitha programeve në gjuhën Angleze dhe Shqipe që zhvillohen në këtë universitet, por bashkëpunimi specifik për programin Shqip ka qenë në nivel modest.</p> <p>UNYT synon dhe orienton bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet aktiviteteve të vazhdueshme informuese dhe shkëmbimit të informacionit, të tilla si prezantime të Punimeve Shkencore në nivel Master dhe PhD, zhvillimi i seminareve informuese/ trajnuese si “Faculty Development Workshop”, “Teaching in Higher Education” etj.”.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, UNYT harton objektivat për çdo departament ku përfshihen edhe objektivat individuale të stafit akademik. Mbi këtë bazë harmonizohen përpjekjet e përbashkëta në nivel ndër-departamental dhe universitar. Në përfundim të vitit akademik bëhet raportimi për nivelin dhe cilësinë e arritjes së këtyre objektiveve.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime</p>	<p>GVJ konstaton gjithashtu se UNYT ka vendosur marrëdhënie të mira bashkëpunimi me institucione partnere të huaja dhe vendase. Nga dokumentacioni por edhe nga vizita në institucion, dhe takimet me drejtues të fakultetit dhe veçanërisht të qendrës kërkimore vihet re se roli që kjo qendër mund të luajë në nxitjen e kërkimit shkencor, në forcimin e lidhjeve me bizneset/NGO/institucionet lokale, kombëtare, dhe ndërkombëtare, pra në rrjetëzimin e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimeve, është shumë herë më i madh se sa ai aktual.</p> <p>Studentët do të synonin më shumë internshipe në të</p>



profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

**Kriteri 4** Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

ardhmen, por edhe biznesi duhet të jetë më shumë i orientuar sipas nevojave/sectorëve prioritarë të vendit, ku institucioni të ofrojë mbështetjen e vet.

UNYT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me komunitetin e biznesit me të cilat garanton trajnimin dhe konsolidimin e aftësive praktike të studentëve të tij. Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit është pasiv.

UNYT ka organizuar takime dhe prezantime të menaxherëve të praktikës me studentët e programit Shqip, si dhe ka organizuar vizita të studentëve në qendra të ndryshme të biznesit.

UNYT i ka vlerësuar si të dobishme vendosjen e marrëdhënieve me institucionet partnere dhe ato të biznesit por nuk ka bërë një analizë të posaçme dhe raport analitik të përfitimeve nga ky bashkëpunim.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Vihet re një politikë që institucioni mundohet të nxisë dhe promovojë përmes politikave të veta. Qasja ndaj kërkimit, mësimdhënies, rezultojnë në një përafrim të mundshëm të reflektuar në marrëdhëniet kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Qendra kërkimore brenda institucionit duhet të luajë rol më aktiv. Nga dokumentacioni por edhe nga vizita në institucion, dhe takimet me drejtues të fakultetit dhe veçanërisht të qendrës kërkimore vihet re se roli që kjo qendër mund të luajë në nxitjen e kërkimit shkencor, në forcimin e lidhjeve me bizneset/NGO/institucionet lokale, kombëtare, dhe ndërkombëtare, pra në rritëzimin e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimeve, është shumë herë më i madh se sa ai aktual.

**Rekomandohet** që në të ardhmen të punohet dhe orientohet fort edhe drejt rritjes së numrit të pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit dhe synimit për të patur disa rekorde edhe në pasjen e Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.

**Rekomandohet** (kjo mbështetet edhe nga drejtues të sigurimit të cilësisë) që në të ardhmen të hapet një qendër/zyrë projektesh e cila të jetë aktive brenda departamentit, në këtë mënyrë orienton kërkimin drejt stafit dhe studentëve dhe i përfshin aktivisht ata.

**Rekomandohet** një politikë më agresive marketingu, jo vetëm përmes mediave sociale dhe formave koherente të marketingut të sotëm, por edhe një qasje më e shtrirë në diversifikim të elementëve të shumtë e të ndryshëm që mund dhe duhet të përdorë institucioni për të patur një qasje sa më aktive nga tregu kombëtar dhe ai ndërkombëtar.

**Gjykojmë dhe rekomandojmë** se kontributi që institucioni jep në kërkimin shkencor përveç numrit të artikujve dhe konferencave që stafi akademik kryen për qëllime të kërkimeve personale (studime doktorale apo për tituj), duhet të matet dhe vlerësohet edhe me nivelin e kërkimeve të vlerësuara nga pikëpamja ndërkombëtare, apo me analiza/studime që institucioni ofron në mbështetjen/zhvillimin e ekonomisë shqiptare (kjo do të rriste edhe cilësinë e bashkëpunimeve brenda vendit si dhe shërben si element i fuqishëm marketingu apo element PR)



## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT


Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

### a. **Pika të forta:**

1. Imazhi, reputacioni dhe emri i mirë i institucionit i mbështetur në ofrimin e njohurive bashkëkohore, cilësore dhe në përputhje me standarte ndërkombëtare, cilësi që demonstron qartë nëpërmjet konsolidimit të programit të studimit në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e përcaktuara në “Strategjinë e zhvillimit të programit”.
2. Marrëveshjet me universitete ndërkombëtare, përpuethshmëria me programe të ngjashme në universitete prestigjioze në ShBA.
3. Niveli i lartë i kualifikimit të stafit akademik.
4. Zgjerimi i bashkëpunimit kombëtar, ndërkombëtar e marrëdhënieve me publikun.
5. Infrastruktura akademike, e ndërtuar me kujdes, në shërbim të cilësisë së mësimdhënies, por edhe duke i kushtuar vëmendje mirëqenies së stafit akademik dhe studentëve.
6. Mundësia e përdorimit të literaturës cilësore në gjuhë të huaj.
7. Liria akademike dhe fleksibiliteti i tematikës si edhe i metodave të mësimdhënies.
8. Mbështetja, këshillimi dhe udhëheqja e studentëve përgjatë aktivitetit akademik në shkollë.
9. Lidhja me studentëve jo vetëm gjatë periudhës në të cilën ata ndjekin studimet, por sidomos pas përfundimit të studimeve.

### b. **Pika të dobëta:**

1. Mungesa e një studimit tregu, analize ekonomike sektoriale e vendit, dhe një analize krahasuese me vendet e rajonit për të kuptuar prirjet në sistemin arsimor dhe zhvillimet përkatëse (nevoja, zhvillime, tendenca). Tregu i punës dhe analiza koherente e tij, me prirjet dhe orientimet kryesore të zhvillimit, nuk janë të përditësuara.
2. Ngarkesa mësimore është tepër e lartë, e shprehur si në numrin mesatar të orëve në auditor, ashtu edhe në numrin e lëndëve, të zhvilluara nën përgjegjësinë e një lektori.
3. Niveli i ulët i kërkimit shkencor i stafit akademik, i demonstruar edhe me nivelin e kërkimeve të vlerësuara nga pikëpamja ndërkombëtare, apo me analiza/studime që institucioni ofron në mbështetjen/zhvillimin e ekonomisë shqiptare.
4. Lista e bizneseve kombëtare me të cilët institucioni bashkëpunon nuk është e përditësuar, ndërsa numri i bizneseve prodhuese dhe të shërbimit është i kufizuar.
5. Kosto e lartë e studimeve për një person.
6. Mungesa e një strategjie cilësore promovimi të UNYT, mbështetur mbi analizën e karrierës të “ish-studentëve” dhe rolin që UNYT ka luajtur në formimin e tyre profesional e social.
7. Pamjaftueshmëria e literaturës në gjuhën shqipe, krahasuar me literaturën në gjuhën angleze.





c. **Mundësitë:**

1. Marëveshjet e shumta me institucione ndërkombëtare, organizata profesionale dhe kompani biznesi, të cilat nëse përdoren efektivisht, do të ndikojnë në rritjen e nivelit të kërkimit dhe do të përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies.
2. Nëse institucioni do të bashkëpunojë me një numër më të madh biznesesh prodhuese si edhe shoqëri shërbimi, do të krijojë më shumë mundësi për praktika (internshipe) ashtu edhe mundësi punësimi për studentët.
3. Ndryshimi i pronarit të institucionit mund të paraqisë shanset për një zhvillim të ri, nëse Strategjia e Drejtimit të ri do të ndërtohet me kujdes, mbështetur mbi analizën e thellë të situatës dhe nevojën e tregut.

d. **Pengesat:**

1. Ndryshimi i menaxhimit të të gjithë institucionit dhe mënyra me të cilën ky ndryshim do të perceptohet nga tregu, mund të shndërrohet në pengesë.
2. Ndryshimi i adoptuar së fundmi në Programin Bsc Administrim Biznesi, që ende nuk është përthithur nga tregu, mund të vazhdojë të jetë pengesë serioze për aktivitetin e institucionit.
3. Prurjet e ulëta dhe mos perceptimi i duhur nga tregu për programin e vlerësuar.
